



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



# MANUALI PËR SPECIFIKIME TEKNIKE PËR FURNIZIME DHE SHËRBIME TË ZAKONSHME

KY MANUAL ËSHTË PËRGATITUR NGA KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË ME MBËSHTETJE TE AKTIVITETIT TË USAID-IT PËR INTEGRITET TË KOMUNAVE TË KOSOVËS. QËNDRIMET E AUTORIT TË SHPREHURA NE KËTË DOKUMENT NUK PËRFAQËSOJNË MEDOEMOS PIKËPAMJET E AGJENCISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA PËR ZHVILLIM (USAID) APO TË QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA.



# PËRMBAJTJA

|   |    |
|---|----|
| HYRJE   | 2  |
| MANUALI PËR SPECIFIKIME TEKNIKE   | 3  |
| QËLLIMI   | 3  |
| PSE ËSHTË E RËNDËSISHME TË SHKRUASH NJË SPECIFIKIM TEKNIK?                | 3  |
| ÇFARË DUHET TË DINI PARA SE TË SHKRUANI NJË SPECIFIKIM TEKNIK?            | 3  |
| SPECIFIKIMET PËR MALLRAT NË PËRGJITHËSI MUND TË NDAHEN NË KATËR KATEGORI  | 3  |
| I. PASTRIMI I OBJEKTEVE   | 5  |
| 1. SQARIME PËR TERMET E PËRDORURA   | 5  |
| 2. PLANI I ORGANIZIMIT TË KRYERJES SË SHËRBIMEVE TË PASTRIMIT - OBLIGIMET | 5  |
| 3. SIGURIA NË PUNË  | 6  |
| 4. MOSKRYERJA E SHËRBIMEVE NË MËNYRË KUALITATIVE                          | 7  |
| 5. OBLIGIMET E PUNËDHËNËSIT NDAJ OFRUESIT TË SHËRBIMEVE                   | 7  |
| 6. ORARI I PUNËS  | 7  |
| 7. PËRSHKRIMI I DETYRAVE THEMELORE  | 8  |
| 8. BARTJET  | 10 |
| 9. MATERIALI PËR MIRËMBAJTJE HIGJIENIKE                                   | 14 |
| 10. INFORMATA SHITESË   | 15 |
| 2. MIRËMBAJTJA E VETURAVE   | 16 |
| PËRSHKRIMI I SHËRBIMEVE NDIHMËSE  | 20 |
| 3. FURNIZIM ME PELET  | 24 |
| 4. FURNIZIM ME DRU  | 25 |
| 5. FURNIZIM ME MATERIAL HIGJIENIK   | 27 |
| 6. SIGURIMI I OBJEKTEVE   | 32 |
| SHEMBULL I PËRSHKRIMIT TE ÇMIMEVE   | 35 |
| 7. SHËRBIME TË TRANSPORTIT  | 36 |
| 8. SHËRBIME TË VEÇANTA  | 37 |
| 9. DDD SHËRBIMET  | 40 |
| 9.1 DEZINSEKTIMI HAPËSINOR  | 40 |
| 9.2 DERATIZIMI I GARAZHEVE /PODURIMEVE PUBLIKE DHE RRJETIT TË KANALIZIMIT | 43 |
| 9.3 DEZINFEKTIMI, DEZINSEKTIMI DHE DERATIZIMI I INSTITUCIONEVE ARSIMORE   | 44 |
| 9.4 DERATIZIMI, DEZINFEKTIMI DHE DEZINSEKTIMI NË OBJKTET SHËNDETËSORE     | 46 |
| 10 . LARJA E JASHTME DHE PASTRIMI I BRENDSHËM I AUTOMJETEVE ZYRTARE       | 47 |
| 11. SIGURIMI DHE KONTROLLIMI TEKNIK I AUTOMJETEVE ZYRTARE                 | 49 |

## HYRJE

Hartimi i specifikimeve teknike është pjesë shumë e rëndësishme dhe kritike për implementim të suksesshëm të projekteve publike dhe ofrim të shërbimeve më të mira për qytetarët. Për këtë arsye dhe me qëllim që Njësitë e Kërkesave të Autoriteteve Kontraktuese (AK) të asistohen në hartimin e specifikimeve teknike, KRPP me mbështetje të Aktivitetit të USAID-it për Integritet të Komunave të Kosovës (KMI) ka hartuar një manual për specifikime teknike për disa furnizime me mallra dhe shërbime të institucioneve publike.

Ky manual mbi specifikimet teknike mbulon shërbimet në vijim:

1. Pastrimi i objekteve
2. Mirëmbajtja e automjeteve
3. Furnizim me pelet
4. Furnizim me dru
5. Furnizim me material higjienik
6. Sigurimi i objekteve
7. Shërbime të transportit
8. Shërbime të veçanta - konsulenca
9. DDD shërbimet (dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi)
10. Larja dhe pastrimi i automjeteve zyrtare dhe
11. Sigurimi dhe kontrollimi teknik i automjeteve zyrtare

Manuali është i rëndësishëm sepse promovon barazinë, transparencën, efikasitetin dhe llogaridhënien në procesin e prokurimit. Manuali ndihmon zyrtarët e njërive kërkuese të marrin vlerën më të mirë për para duke zvogëluar rrezikun potencial për mosmarrëveshje apo korrupsion. Manuali gjithashtu siguron pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe rregullative, në dobi të interesit publik dhe të furnitorëve të përfshirë në proces të prokurimit publik.

Specifikimet teknike, në përgjithësi, janë shumë të rëndësishme sepse ofrojnë një përshkrim të qartë dhe të detajuar të shërbimeve të kërkuara nga një autoritet kontraktues. Specifikimet teknike të përpiluara mirë ndihmojnë furnizuesit potencial të kuptojnë saktë kërkesat, duke reduktuar ndërlikimet dhe duke siguruar që konkurrenca të jetë e drejtë dhe e hapur për të gjithë furnizuesit e kualifikuar. Njëkohësisht ndihmon në parandalimin e diskriminimit dhe siguron që procesi i prokurimit të mos jetë i prirur në favor të një furnizuesi të caktuar, që mund të çojë në parregullsi dhe korrupsion.

Përmes specifikimeve të sakta teknike, Manuali tenton të ndihmojë Autoritete Kontraktuese të sigurojnë vlerën më të mirë për para, duke kërkuar zgjidhjet më të efektshme me kosto të përballueshme që i plotësojnë nevojat e tyre specifike. Gjithashtu, specifikimet teknike të qarta zvogëlojnë rrezikun e mundshëm për mosmarrëveshje midis Autoriteteve Kontraktuese dhe Operatoreve Ekonomik, sepse kur autoriteti e çekë qartë atë që e kërkon, Operoret Ekonomik janë më pak të prirur të ofrojnë produkte ose shërbime që nuk i plotësojnë kërkesat.

Në anën tjetër, specifikimet teknike të mangëta ose të paqarta mund të çojnë në rreziqe të procesit të prokurimit, përfshirë vonesat përmes ankesave, tejkalimet e kostos së paraparë, e deri tek cilësia e ulët. Manuali synon t'i ndihmojë zyrtarët në zvogëlimin e këtyre rreziqeve duke ofruar udhëzime të qarta për shërbimet e lartcekura, duke siguruar pajtueshmëri me rregullat dhe standardet e ndryshme të aplikuara aktualisht në Kosovë.

Në përfundim, qëllimi i këtij Manuali është që të ju ndihmojë dhe lehtësojë punën tuaj në hartimin e specifikimeve teknike të qarta për shërbimet e mësipërme, sepse në fund, kjo do të ndikojë edhe në ndërtimin e besimit tek operatorët ekonomik ndaj autoritetit ku ju shërbeni, dhe në përmirësimin e perceptimit publik në përgjithësi. Qytetarët janë më të gatshëm të kenë besim në institucionet publike kur shohin praktika të drejta dhe të përgjegjshme që aplikohen në proces të prokurimit publik.

# MANUALI PËR SPECIFIKIME TEKNIKE

## QËLLIMI

Ky manual është hartuar për asistim të Njësive Kërkuese dhe zyrtareve të prokurimit në hartimin e specifikimeve teknike për furnizime dhe shërbime të zakonshme. Manuali ofron detaje të hartimit të specifikimeve teknike për disa furnizime dhe shërbime të zakonshme.

## PSE ËSHTË E RËNDËSISHME TË SHKRUASH NJË SPECIFIKIM TEKNIK?

Specifikimet teknike kanë përfitime të mëdha për të gjithë të përfshirët në një projekt: njësitë e kërkesave që i shkruajnë ato dhe njësitë që i përdorin ato.

Hartimi i mirë e korrekt i një specifikimi teknik rrit gjasat për të pasur një projekt, shërbim apo furnizim të suksesshëm me të cilin do të jenë të kënaqur të gjithë akterët e përfshirë në proces si dhe zvogëlon mundësinë që diçka të shkojë keq gjatë implementimit të kontratës.

## ÇFARË DUHET TË DINI PARA SE TË SHKRUANI NJË SPECIFIKIM TEKNIK?

- Mblidhni informacionin ekzistues në fushën e problemit përpara se të filloni.
- Lexoni mbi kërkesat e produkteve / veçorive që ekipi i produkteve ka prodhuar, si dhe kërkesat / standardet teknike të lidhura me projektin.
- Me këtë njohuri të historisë së problemit, përpikuni të tregoni problemin në detaje dhe të merrni ide për të gjitha llojet e zgjidhjeve që mund të mendoni se mund ta zgjidhin atë.
- Zgjidh zgjidhjen më të arsyeshme nga të gjitha opsionet që ke dalë.

Hartimi i specifikimeve teknike mund të jetë një mënyrë ndikuese për të garantuar që projekti juaj do të jetë i suksesshëm.

## SPECIFIKIMET PËR MALLRAT NË PËRGJITHËSI MUND TË NDAHEN NË KATËR KATEGORI

1. specifikimet e projektimit,
2. specifikimet e performancës,
3. specifikimet funksionale dhe
4. emri i markës ose specifikimet e barabarta.

## I. SPECIFIKIMET E PROJEKTIMIT

Autoriteti kontraktues përcakton në mënyrë të detajuar karakteristikat teknike të mallrave që do të prokurohen. Këto specifikime mund të kenë vizatime, matje, tolerance, procedura të testimit dhe detaje të tjera të veçanta teknike. Specifikimet e projektimit përdoren kur Autoriteti Kontraktues do të sigurojë performancën teknike të një artikulli të kërkuar. Ato mund të përdoren, përveç kësaj, në mënyrë që të standardizohet mallrat e blera. Përdorimi i një specifikimi të projektimit, Autoriteti Kontraktues do të marrë mallrat pikërisht ashtu siç kërkon, por edhe mbart rrezikun e ndonjë problemi apo defekti në hartimin e tij.

## 2. SPECIFIKIMET E PERFORMANCËS

Zakonisht janë më pak të definuara se specifikimet të projektimit. Ato e përshkruajnë punën e dëshiruar nga ajo që Autoriteti Kontraktues është duke siguruar, pa e drejtuar në mënyrë specifike kontraktuesin mbi detajet teknike të sendit që do të dërgohet.

Për shembull, specifikimi i performancës mund të deklarojë se enti prokurues dëshiron një pajisje që mund të prodhojë 60 kopje për minutë dhe nga furnizuesi kërkohet të gjendet zgjidhja më e përshtatshme për të arritur këtë rezultat (fotokopjues ose kombinim i skanerit / printerit ?).

Specifikimet e performancës ndonjëherë quhen specifikime funksionale ose të rezultatit, sepse ato përqendrohen në funksionalitetin ose rezultatin që duhet arritur. Specifikimet e performancës japin një tregues të qartë të qëllimit për të cilin kërkohet artikulli dhe kjo kërkesë i komunikohet plotësisht operatorëve ekonomikë. Ndryshimi këtu është se operatorët ekonomikë më pas nxiten të përdorin ekspertizën e tyre për të ofruar zgjidhje (produkte dhe/ose shërbime), të cilat nga pikëpamja e ekspertit, përmbushin më së miri nevojën e specifikuar nga autoriteti kontraktues.

### 3. SPECIFIKIMET FUNKSIONALE

Ato janë të ngjashme me specifikimet e performancës se ato vendosin përgjegjësi për karakteristikat teknike të sendit mbi furnizuesit. Por, në vend se duke theksuar nevojat në aspektin e standardeve të performancës, specifikimet funksionale të përqendrohen në qëllimin ose përdorimin e objektit.

Për shembull, nga furnizuesi kërkohet të sigurohet një makinë që mund të mbajnë 20 njerëz në mënyrë të sigurtë nëpër rrugë jo të asfaltuara në të gjitha kushtet atmosferike.

Një specifikim funksional mund të përmbajë përshkrime formale të detyrave të përdoruesit, varësitë

#### **Një shembull i një specifikimi të performancës mund të jetë:**

Nëse do të nevojitej kondicionim ajri për një dhomë, një specifikim i performancës do të tregonte se kërkesa është që dhoma, me 20 persona me nga një kompjuter secili dhe me dy printerë, duhet të mbahet në një temperaturë 20 gradë Celsius, kur temperatura jashtë është midis -10°C deri në 32°C. Në këtë kuptim, karakteristikat e përbashkëta dhe pajtueshmëria arrihen, sepse operatorët ekonomikë përpiqen të japin një zgjidhje me kosto efikase për kërkesën, pa qenë nevoja që kërkesa të jetë përshkruese.

mbi produktet e tjera, si dhe kriteret e përdorimit. Shumë kompani kanë një udhëzues që përshkruan se çfarë specifikime funksionale çdo produkt duhet të përmbajë.

### 4. EMRI I MARKËS OSE SPECIFIKIMET E BARABARTA

Në raste të veçanta, kur është dokumentuar mjaftueshëm, specifikimet mund të përshkruajnë sendin që të prokurohet nga emri i një marke. Kjo nganjëherë quhet "marke ekskluzive".

Në raste të tilla specifikimi duhet të deklarojë se një "produkt i barabartë" është gjithashtu i pranueshëm, d.m.th. specifikimet duhet të përcaktojnë karakteristikat e rëndësishme fizike, funksionale dhe të tjera të produktit të cilat janë thelbësore për Autoritetin Kontraktues dhe të çojë në prokurimin e sendit të caktuar. Specifikimet e publikuara duhet të jenë të mjaftueshme për të verifikuar se një artikull i propozuar është "i barabartë".

**Shembujt e mëposhtëm janë shembuj referues të cilat mund të përdoren nga AK gjatë përpilimit të specifikimeve teknike. Gjithashtu disa nga shembujt përmbajnë edhe kërkesa të veçanta të kualifikimit të cilat janë konform legjislacionit përkatës në fuqi.**

# I. PASTRIMI I OBJEKTEVE

## I SQARIME PËR TERMET E PËRDORURA

Me termin “**Mirëmbajtja Higjienike e Ndërtesave Publike të Autoriteteve Kontraktuese**” nënkuptohet realizimi i të gjitha punëve të nevojshme lidhur me pastrimet – mirëmbajtjen e higjienës në ndërtesa në mënyrë që të përmbushen kërkesat për zbatimin e ligjit mbi mbrojtjen në punë me të cilat duhet krijuar kushtet normale për punë të shfrytëzuesve të hapësirave në kuadër të ndërtesave publike të Autoriteteve Kontraktuese.

Mirëmbajtja higjienike përfshinë realizimin e punëve për:

- Mirëmbajtjen e pastërtisë në të gjitha hapësirat e ndërtesës;
- Mirëmbajtjen e shtigjeve të këmbësorëve si dhe të parkingjeve të automjeteve;
- Mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara;
- Largimin e mbeturinave – nga ndërtesa deri te kontejnerët qendrorë për mbeturina;
- Bartjet e materialeve, inventarit etj. brenda në ndërtesa si dhe bartjet në mes të ndërtesave publike të Autoritetit Kontraktues.

Termi “**Ndërtesa publike të Autoritetit Kontraktues**” nënkupton AK apo institucionet e tjera që funksionojnë në kuadër të Autoritetit Kontraktues e që paraqet kompleksin i cili përbëhet prej:

- Ndërtesës apo kompleksit të objekteve në një hapësirë të kufizuar (ndërtesat me të gjitha hapësirat).
- Kthinat, nga bodrumet gjer në kulmet, komunikimin horizontal dhe vertical.
- Komunikimin emergjent duke përfshirë fasadat e jashtme dhe parterin.
- Objekteve ndihmëse: kontejnerët, pikat e sigurimit etj.
- Shtigjet e këmbësorëve.
- Parkingjet.
- Hapësirat e gjelbëruara.
- Rrethojat dhe portat (normale, laura, rrëshqitëse etj.).

## 2. PLANI I ORGANIZIMIT TË KRYERJES SË SHËRBIMEVE TË PASTRIMIT - OBLIGIMET

Në planin e organizimit të Ofruesit të shërbimeve duhet patjetër të përfshihet edhe numri minimal i kryeseve të secilit profil, të udhëhequr nga Menaxheri i Ofruesit të shërbimeve.

Punëdhënësi ka të drejtë dhe obligim të kontrollojë dhe kërkojë rritjen e cilësisë së ofruar të shërbimeve dhe nëse vlerëson se me punëtorët aktual nuk arrihet ofrimi i shërbimeve cilësore, Ofruesi i shërbimeve obligohet që të merr masat e duhura që të rritë cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Ofruesi i shërbimeve gjatë gjithë kohës duhet të ketë punëtorë të mjaftueshëm pavarësisht nga obligimet e Ofruesit të shërbimeve ndaj punëtorëve të tij (Pushime vjetore, pushimet mjekësore etj.).

Ofruesi i shërbimeve për çdo javë do të dorëzoj listën e kërkesave të realizuara dhe specifikimin e materialit të shpenzuar për realizimin e këtyre kërkesave.

Ofruesi i shërbimeve duhet mbajtur historikun për punët e kryera në sisteme dhe hapësira për secilën ndërtesë dhe lami në veçanti, duke u bazuar në punët e kryera sipas kërkesave, planeve, ditarit të punës dhe ditarin e kujdestarisë.

Ofruesi i shërbimeve obligohet që dy deri tri ditë para se të filloj muaji i ri, përmes shkresës zyrtare të dorëzoj listën e punëtorëve të cilët do të angazhohen për kryerjen e punëve për muajin i cili pason.

Punëtorët e Ofruesit të shërbimeve duhet të janë profesional me njohuri të nevojshme për kryerjen e punëve të mirëmbajtjes higjienike, bartjeve e të ngjashme.

Ofruesi i shërbimeve dhe i gjithë stafi i tij gjatë kryerjes së punëve të mirëmbajtjes duhet përmbajtur rregullave të kodit të sjelljes në objektet publike të AK dhe rregullave specifike varësisht nga fushëveprimi i institucioneve që veprojnë në ndërtesë.

Punëdhënësi do të shfrytëzojë të drejtën që të kërkojë që në shpenzime të Ofruesit të shërbimeve të rregullohet dëmi i shkaktuar pa kompensim financiar dhe njëherit do i bën edhe vërejtje në rastet kur Ofruesi i shërbimeve gjatë kryerjes së punëve për shkak të neglizhencës, profesionalizmit dhe kryerësve të pamjaftueshëm, e të ngjashme, shkakton defekte, avari, në pajisje dhe sisteme për rregullimin e të cilave kërkohet material shtesë dhe angazhime shtesë.

Ofruesi i shërbimeve është i obliguar të aplikojë ligjin për mbrojtje në punë në tërësi pra të:

- Siguron uniformat adekuate me mbishkrimet e kompanisë, për të gjithë punëtorët e tij
- Siguron veglat dhe mjetet personale për punëtorët e tij
- Siguron veglat dhe pajisjet për kryerjen e të gjitha punëve të nevojshme individuale dhe grupore për realizimin e suksesshëm të mirëmbajtjes higjienike, akomodimeve, bartjeve, pastrimin e fasadave kulmeve, mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbërimit etj
- Automjetet dhe mekanizimin për transport
- Si dhe kërkesa tjera në harmoni me obligimet kontraktuese dhe me ligjin e punës.

### **3. SIGURIA NË PUNË**

Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aplikimin e ligjeve për mbrojtje në punë të punëtorëve të tij përveç tjerash edhe duke :

- Bërë sigurimin e zonave të punës për kryerjen e punëve në mënyrë të sigurt
- Duke u siguruar në gatishmërinë profesionale të punëtorëve
- Duke u siguruar në përdorimin e drejt të veglave dhe mjeteve adekuate dhe funksionale nga punëtorët
- Duke obliguar punëtorët që të mbajnë uniformat e kompanisë (uniforma duhet identifikuar kompaninë) si dhe rrobat e punës dhe mjetet mbrojtëse në punë si: rrobe pune adekuate, helmata, këpucë adekuate varësisht nga natyra e punës dhe stina, syza mbrojtëse, dorëza pune etj.
- Nga bartja e uniformës lirohet vetëm menaxheri i kontratës dhe askush tjetër nga punëtorët e kompanisë.



- Varësisht nga natyra e punës të angazhoj punëtorë me kualifikime adekuate, njohuri dhe përvojë të duhur për kryerjen e punëve të nevojshme.
- Si dhe aplikimin e nevojave tjera në harmoni me obligimet kontraktuese dhe me ligjin për mbrojtje në punë.

#### **4. MOSKRYERJA E SHËRBIMEVE NË MËNYRË KUALITATIVE**

Punëdhënësi ka të drejtën të aplikoj ndalesën e pjesshme të vlerës së kontraktuar për arsyet të cilat do të vlerësohen si mos përmbushje e obligimeve kontraktuese si:

- Moskryerja e shërbimeve në tërësi apo pjesërisht sipas cilësisë së nevojshme e të kërkuar;
- Zgjatja e afatit të kryerjes së punëve;
- Mos kompletimin i punëve të nevojshëm si dhe të kërkuar nga punëdhënësi;
- Mosrespektimi i mirësjelljes, orarit, qëndrimit ndaj punëve, qëndrimit ndaj shërbyesve civil, dhe zyrtarëve tjerë që punojnë në këto ndërtesa, e të ngjashme.

Gjithashtu në bazë të vlerësimeve nga Menaxheri i AK-ës mundë të ketë edhe kërkesa për largimin e punëtorit/ës të caktuar të ofruesit të shërbimeve nga vazhdimi i punës së mëtejme në ndërtesë, gjë të cilën ofruesi i shërbimeve duhet aplikuar me zëvendësim të punëtorit/ës së caktuar me një tjetër.

Nëse punëdhënësi – Menaxheri i AK-ës nuk është i kënaqur me shërbimet e ofruara nga ofruesi i shërbimeve, dhe pas tërheqjes së vërejtjes gjendja nuk ndryshon në të mirë, ka të drejtën të marrë masa ndëshkuese dhe së fundi nëse edhe kjo masë nuk ngrit nivelin e shërbimeve të ofruara menaxheri i AK-ës do të kërkoj shkëputjen e kontratës.

Pas nënshkrimit të kontratës, ofruesi i shërbimeve duhet të prezantojë listën e stafit me profesionet adekuate me të cilin planifikon kryerjen e punëve në ndërtesë.

Për secilin punëtor të cilin do ta angazhojë ofruesi i shërbimeve në realizimin e punëve duhet ofruar kontratën valide së paku për 6 muajt e ardhshëm.

#### **5. OBLIGIMET E PUNËDHËNËSIT NDAJ OFRUESIT TË SHËRBIMEVE**

Punëdhënësi ndaj ofruesit të shërbimeve ka për obligim:

- Të siguroj hapësira për ekipet e punëtorëve të Ofruesit të Shërbimeve në kuadër të ndërtesës;
- Të siguroj kartelet identifikuese për qasje në ndërtesë sipas kërkesës dhe listës së punëtorëve të drejtuar nga drejtori i ofruesit të shërbimeve dhe sipas procedurave të AK-ës;
- Të siguroj leje për qasje në ndërtesë për mjetet transportuese të Ofruesit të Shërbimeve sipas kërkesës së drejtuar nga drejtori i Ofruesit të Shërbimeve;
- Të bëjë procedimin e faturave mujore për pagesë sipas procedurave dhe obligimeve ligjore.

#### **6. ORARI I PUNËS**

Orari i rregullt i punës do të jetë prej orës (8.00 – 16.00) për çdo ditë pune ( e Hënë – e Premte).

Orari i paraqitur nuk do të vlejë asnjëherë kur të ketë nevojë për të kryer ndonjë punë e cila nuk ka përfunduar gjatë orarit të rregullt të punës, apo më kërkesë nga përgjegjësit për të vazhduar punën gjatë ditëve të punës apo për të punuar edhe gjatë fundjave, pa kompensim shtesë financiar në emër të punës jashtë orarit. Kjo vlen për të gjithë punëtorët e kompanisë pa përjashtime sipas nevojës, por kjo nuk do të thotë që ofruesi i shërbimeve duhet pasur punëtorë shtesë tërë kohën, por kjo do të thotë se vlenë dhe duhet aplikuar për raste të caktuara.

## 7. PËRSHKRIMI I DETYRAVE THEMELORE

### 7.1.1 MIRËMBAJTJA HIGJENIKE

Nga ofruesit e shërbimeve kërkohet që pastrimi të organizohet në atë mënyrë që hapësirat e përbashkëta (korridoret, shkallët, tualetet, hapësirat e gjelbëruara, parkingjet, shtigjet e këmbësorëve, rrugët, pllato etj.) të pastrohen para orës 9.00 të mëngjesit ndërsa pas orës 8.00 të bëhet pastrimi i zyrave, sallave, etj.

**Pastruesja/si** - Kryen shërbimet e mirëmbajtjes së pastrimit - pastrimin e zyreve, orendive, korridoreve, shkallëve, dyshemeve, tualeteve, hapësirave tjera të jashtme dhe të brendshme të ndërtesave, fasadave, etj.

**Pastrimi Fillestar** - Pa marrë parasysh shpeshhtësinë – nivelin e pastrimit, ofruesi i shërbimeve duhet të kryejë të gjitha detyrat e pastrimit fillestar të përshkruar në listën e shërbimeve të pastrimit në afat prej (15 ) ditëve të para të kontratës që të sigurojë një pastërti standarde të llogaritur që nga fillimi. Pas këtij (pastrimit fillestar – pastrimi gjeneral ), ofruesi i shërbimeve duhet të vazhdoj me shërbimet e pastrimit. Pastrimi fillestar nuk paguhet me pagesë të posaçme.

**Detyrat ditore** - Ofruesi i shërbimeve është përgjegjës që të përkujdeset që këto hapësira të jenë të pastra në çdo kohë sipas standardeve të mëposhtme. Është përgjegjësia e ofruesit të shërbimeve të përkujdeset që këto standarde të mirëmbahen duke aplikuar intervalin e pastrimit sipas nevojës gjatë ditës për të mirëmbajtur një shërbim pa kurrfarë lëshimesh, prandaj varësisht nga angazhimet e pastrueseve ofruesi i shërbimeve cakton numrin e mjaftueshëm të pastrueseve.

**Pastrimi i Dyshemesë** - Pas kryerjes së pastrimit të dyshemesë, dyshemeja duhet të lihet në gjendje të pastër pa njolla dhe sipas nevojës në gjendje të thatë varësisht nga lloji i dyshemesë. Pastrimi duhet të kryhet në tërë sipërfaqen përfshirë qoshet, hapësirat mbrapa dyerve, hapësirave nën mobilie dhe pajisjeve e tjera. Mobilet dhe pajisjet duhet të zhvendosen gjatë procesit të pastrimit dhe të kthehet në vendin e vet fillestar posa të kryhet pastrimi. Karriget asnjëherë nuk duhet të vendosen në tavolina ose tryeza. Pastrimi i tepihëve dhe dyshemeve duhet të kryhet në atë mënyrë, që tepihët dhe dyshemeja pas pastrimit të mos rrëshqas dhe mos të humbin ngjyrat. Të gjitha mbeturinat duhet të vendosen në shporta të mbeturinave dhe të largohen jashtë objektit (të hidhen në kontejner). Shenjat paralajmëruese **“sipërfaqja e lagësht”** duhet të vendoset në vendet e dukshme në të gjitha katet dhe korridoret gjatë procesit të pastrimit me ujë, dhe duhet të largohen sapo të thahen sipërfaqet.

**Pastrimi i rastit** - Pastrimi në vend të pa pastër (rastit) duhet të definohet si të kryhet puna largimi me dorë i ndonjë gjëje, pastrim i thjeshtë, fshirja me leckë të lagur ose pastrimi me thithëse elektrike të hapësirave të vogla, të cilat janë të lagura, derdhjet e ndryshme, njollat ose mbeturinat. Pastrimi në vend përfshin largimin e ujit, papastërtisë, rërës, njollave të shkaktuara nga hapjet e dyerve në vendet me qarkullim të madh.

**Fshirja** - duhet të kryhet me anë të fshesave, brushave, leckave të pluhurit dhe thithësve elektrike pa zhurmë. Dyshemeja do të konsiderohet e pastër kur nuk është e lagur, nuk ka mbeturina, pluhur të dukshëm, grimca dhe mbeturinat të ushqimit e të tjera.

**Pastrimi me thithëse elektrike** - Pastrimi me thithëse elektrike kryhet me thithëse elektrike pa zhurmë për tepihë, në fshesë duhet të vendoset thithësja në formë brusheje. Tepihu konsiderohet i pastruar kur nuk ka njolla, mbeturina dhe copëza dhe si dhe copëza të tjera.

**Fshirja me leckë të njomë** - Fshirja me leckë nevojitet për të pastruar hapësirat e dyshemesë së drurit kur pastrimi i lagësht nuk është i dëshirueshëm. Pas fshirjes, pastrimi i njomë mund të arrihet duke shfrytëzuar leckën e lagur në tretje detergjenti/dezinfektuesi dhe shtrydhja e saj deri sa të jetë e lagur. Dyshemeja e pastruar mirë me leckë është ajo që nuk ka pluhur, njolla , cipë të hollë pluhuri, vija të dukshme të ndryshme, mbeturina dhe ujë të mbetur.

**Pastrimi me leckë plotësisht të lagur** - Pastrimi me leckë plotësisht të lagur bëhet pas fshirjes së dyshemesë dhe në hapësirat ku nuk janë të vendosura tepihët – në dyshemetë gjysmë të nxehta dhe të ftohtë duke shfrytëzuar lecka pambuku ose shpuzë. Leckat duhet të zhyten më shpesh në ujë të pastër dhe tretje detergjenti dhe dezinfektuesi për të larguar papastërtia. Dyshemetë pastaj shpërlahen me leckë të njomë për të larguar të mbeturat e pastrimit të lagësht dhe ujin e tepërt.

**Hedhja dhe pastrimi i mbeturinave** - Kontejnerët – shportat e mbeturinave janë ato që shfrytëzohen për të hedhur mbeturinat e zyrës, dhe mbeturinat tjera. Kontejnerët e mbeturinave duhet të zbrazen dhe të lahen me shpuzë ose leckë të zhytur në tretje detergjenti. Kontejnerët e fshirë nuk duhet të përmbajnë pluhur, papastërti, njolla ose mbeturina. Kontejnerët e mbeturinave duhet të kanë mundësin e vendosjes së qeseve plastike të cilat pastaj hidhen në kontejner të mëdhenj dhe së fundi në kontejnerët gjegjësisht në hapësirat e jashtme të ndërtesave ku grumbullohen mbeturinat nga i tërë objekti dhe pastaj largohet sipas procedurave të posaçme. Të gjitha llojet e shportave–kontejner për hedhjen e mbeturinave i siguron punëdhënësi.

**Kthinat e banjave dhe tualeteve** - Pastrimi i guacave, lavamanëve, tushave, mureve, dyerve, dhe të gjitha hapësirave tjera të lavatoreve bëhet me lecka, shpuzë, lecka të lagura, brusha dhe pajisje të tjera të cilat nuk përdoren më për asgjë tjetër vetëm për banja dhe tualete. Detergjentet duhet të jenë dezinfektuese dhe me aromë të këndshme jo të dëmshme për shëndetin e stafit punues. Kthinat e banjës dhe e tualeteve janë të lara mirë kur edhe hapësirat nën vendosjen e instalimeve të sanitarisë dhe të tjera, gjithashtu edhe të gjitha hapësirat e dukshme janë të pastruara. Të gjitha instalimet duhet të kenë pamje të pastër – shkëlqim pa vija dhe njolla me pamje higjienike. Pastruesit- et duhet gjithmonë të punojnë me dorëza mbrojtëse.

**Lustrimi i metalit** - Lustrimi i metalit kryhet pas fshirjes së lagësht dhe kryhet duke shfrytëzuar një leckë të butë bashkë me mjetin përkatës për lustrim. Sipërfaqja e lustruar mirë është ajo ku nuk ka hapësira të nxira dhe mbeturinat e polirit dhe që ka shkëlqim të njëjësuar në çdo pjesë.

**Pastrimi i mureve dhe i dyerve-** Pastrimi i mureve përfshin muret, shtyllat, ndarjet, dekorimet, radiatorët, tabelat, zbukurimet e ndryshme dhe instalimet në mure. Pastrimi i derës përfshinë dyert, anën (faqet) e dyerve dhe orenditë ose dekorimet në dyer. Pastrimi bëhet me anë të shpuzës së njomë ose leckës së zhytur në tretjen e detergjentit dhe dezinfektuesit. Sipërfaqet e pastruara mire duhet të jenë të shndritshme, të mos kenë papastërti mykë njolla, hapësira të nxira, ose të stërpikura. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet largimit njollave dhe pikave të yndyrshme në hapësirat me qarkullim të madh dhe atje ku dyert shfrytëzohen shumë shpesh. Dera e pastruar mirë nuk duhet të ketë vija ose vende të pa pastra.

**Pastrimi i xhamave dhe pasqyrave** - Xhamat dhe pasqyrat duhet të pastrohen me leckë dhe/ose me shpuzë të lagur në detergjent ose pastrues të xhamit. Kjo duhet ta pasohet nga polirimi (lustrimi) duke përdorur lecka të thara ose peshqir prej letre. Buzët dhe kornizat ngjitas po ashtu duhet të pastrohen dhe të lustrohen. Sipërfaqe qelqi e pastruar mirë është ajo e cila nuk ka pluhur, pa pastërti, vaj, pika, vija, ose mbeturina. Gjatë pastrimit dimëror të gjitha shenjat e vijave, papastërtisë, pikave të ujit dhe materieve të tjera të huaja duhet të largohen nga kornizat, parvazet dhe qelqi me anë të pastruesit adekuat të xhamave. Dritaret e jashtme nuk përfshihen në këtë kërkesë.

**Pastrimi i dritave** - Pastrimi i dritave, poçeve, armaturave, përfshin largimin e mbulesave të dritave dhe fshirjen brenda dhe jashtë të çdo mbulueseje duke përdorur një leckë të lagur, Instalimet fluoreshente, përfshirë tubat (e neonit) dhe zbutësit e shndritjes, duhet të pastrohen lehtë dhe pluhuri ose njollat t'iu fshihen. Drita e pastruar mirë nuk duhet të përmbajë insekte, papastërti, pluhur dhe materiet tjera të jashtme.

**Larja e tepihëve me shampon dhe pastrimi i tapicerive** - Larja e tepihut me shapon është proces i vendosjes së stamponit për tretje higjienike të fijeve të tepihut dhe shfrytëzimi i makinës

ekstraktues për larjen e tepihut. Tepihu i larë mirë me shampon është ai që është pastruar në mënyrë të njëtrajtshme sipas udhëzimeve të prodhuesit të shamponit të përdorur.

**Punët dhe Pastrimet e posaçme** - Menaxheri i kontratës nga ana e punëdhënësit, ose përfaqësuesi i tij/saj i autorizuar mund t'i kërkoj ofruesi i shërbimeve të kryej shërbime në ndërtesë para ose pas vendosjes së personelit. Këto kërkesa aplikohen varësisht nga gjendja e pajisjeve, sistemeve, pastrimit në ndërtesa si dhe në bazë të kërkesave nga ndërtesat. Këto shërbime kryhen nga ofruesi i shërbimeve pa kompensime financiare shtesë. Shërbimet përfshijnë punët si në vijim:

**Hapësirat me tepih:** larja me shampon me metodën e shkumës së tretur dhe largimi i njollave me kemikalie adekuate nga dyshemetë dhe muret

**Xhamat/dritaret:** pastrimi special i pasqyrave/xhamave/qelqit për të larguar njolla dhe shenja.

**Dyshemeja:** Larja mekanike e dyshemesë, vendosja e dyllit, lustrimi me materiale speciale për largimin e njollave të ushqimit dhe shenjave tjera.

**Mobiliet:** Pastrimi special dhe lustrimi i mobilieve me tapiceri.

**Guacat:** Largimi i acideve urinore dhe njollave gëlqerore.

## 7.1.2 SHËRBIMET E KOPSHTARISË DHE ATO TË PËRGJITHSHME

Shërbimet e kopshtarisë dhe ato të përgjithshme përfshijnë:

**Mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbërua** gjatë gjithë kohës duke mbajtur në gjendje të pastër dhe të rregullt, dizajnimi i kopshteve me lule, duke përpunuar dheun, plehrosur si dhe sipas nevojës duke ujitur dhe duke bërë e vejetacionit.

**Mirëmbajtja e vendkalimeve, tarracave, pllatove dhe parkingjeve.**

Njëherit mban rregullsinë dhe gjendjen pa borë dhe akull, sipas nevojës dhe sipas kërkesës nga punëdhënësi krijos dhe hedhë rërë, (rërën dhe kripën e nevojshme e siguron ofruesi i shërbimeve)

Pastron nga gjethet dhe mbeturinat sistemet e drenazimit, kanalizimit, ollukëve dhe gypat tjerë.

Mbeturinat e grumbulluara nga ndërtesa hidhen tek kontejneri ose te vendi tjetër i përcaktuar për atë qëllim.

## 8. BARTJET

Ofruesi i shërbimeve kryen të gjitha bartjet e nevojshme brenda në vet ndërtesën e AK apo nga një ndërtesë në ndërtesën tjetër, pavarësisht a është personeli i të njëjtës ndërtesë të AK apo të personelit të ndërtesave tjera që funksionojnë në kuadër të AK. Ofruesi i shërbimeve për realizimin e bartjeve të ndryshme siguron fuqinë punëtore të nevojshme dhe të gjitha mjetet e nevojshme për transportim duke përfshirë edhe mjetet transportuese nga njëra ndërtesë në ndërtesën tjetër.

Ofruesi i shërbimeve është i obliguar që të siguroj mjetet transportuese - kamionë për bartjen e inventarit dhe materialeve të AK prej një ndërtesë në ndërtesën tjetër (bartjen e inventarit, fajlla të ndryshëm dhe materiale tjera shpenzuese e të tjera). Për këto shërbime duhet të siguroj kamion me mbulesë. Kamioni duhet të ketë volumin e nevojshëm sipas kërkesë për bartje që do të behët nga AK.

Nëse bartja do të organizohet prej një ndërtesë (ndërtesë që e mirëmban njëra kompani) në ndërtesën tjetër (ndërtesa të cilën e mirëmban kompania tjetër) pra kemi rastin ku janë të kyçura dy kompani të ndryshme në realizimin e bartjes, në këtë rast bartja do të realizohet asistojë që:

- Kompania e cila e mirëmban ndërtesën prej ku do të bëhet bartja duhet të siguroj fuqinë punëtore, kamionin pajisjet dhe veglat tjera të nevojshme për realizimin e transportit, të bëjë ngarkimin e gjëseneve në kamion, të transportoj të njëjtat gjerë në ndërtesën ku duhet të vendoset personeli dhe pajisjet e bartura të shkarkojë nga kamioni.
- Kompania e cila mirëmban ndërtesat ku duhet të vendosen personeli dhe pajisjet e bartura, do të pranojnë materialin dhe gjësendet e bartura dhe do t'i bart brenda në ndërtesë dhe do t'i vendos nëpër zyre – hapësira të caktuara sipas planit të përgatitur paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues.

Për realizimin e bartjeve të kërkuara, ofruesi i shërbimeve angazhon fuqinë punëtore , veglat, mjetet, dhe mekanizimin (automjete, kamion, kamion me mbulesë, pirunor, vinça etj.) që të gjitha sipas nevojës gjegjësisht materialit që do të transporton. Për të gjitha llojet e transporteve që do t'i realizon ofruesi i shërbimeve, nuk do të ketë pagesa shtesë, por këto punë duhet llogaritur dhe përfshirë në çmimin mujor të mirëmbajtjes.

| KODET E INTERVALEVE | PERIUDHA E REALIZIMIT      |
|---------------------|----------------------------|
| D                   | Çdo ditë                   |
| D-SN                | Çdo ditë dhe sipas nevojës |
| 2D                  | Dy herë në ditë            |
| J                   | Një herë në javë           |
| M                   | Një herë në muaj           |
| M2                  | Çdo dy muaj                |
| M3                  | Çdo tre muaj               |
| M6                  | Çdo gjashtë muaj           |
| SN                  | Sipas nevojës              |

## PLANI DINAMIK THEMELOR PËR KRYERJEN E MIRËMBAJTJES HIGJIENIKE

| PLANI DINAMIK THEMELOR PËR KRYERJEN E MIRËMBAJTJES HIGJIENIKE  |                        |
|--|------------------------|
| TUALETET DHE BANJOT  | PERIUDHAT E REALIZIMIT |
| Fshirja e dyshemeve  | D-SN                   |
| Fshirja e dyshemeve me ujë të ngrohtë dhe dezinfektues   | D-SN                   |
| Larja dhe dezinfektimi i tualeteve, dusheve dhe lavamanëve   | D-SN                   |
| Larja dhe gërryerja me ujë të ngrohtë dhe sapun dezinfektimi i të gjitha guacave, vendosja e tabletave dezinfektues dhe plastikeve-gomave të shpuara | D-SN                   |
| Larja dhe terja e pasqyrave  | D-SN                   |
| Zbrazja e shportave për letra  | D-SN                   |
| Lustrimi i çesmeve të ujit dhe të gjitha instalimeve   | D-SN                   |
| Pastrimi i mureve, dyerve, dritareve, elementeve tjera   | D-SN                   |
| Largimi i pluhurit nga poçet elektrik, trupat nxehtë, plafonëve  | J                      |
| Vendosja e peshqirëve të letrës, letër tualetit, sapunëve, dhe   |                        |
| Dezodoranteve të guacave   | D-SN                   |
| <b>KORRIDORET SHKALLËT DHE HYRJET</b>  |                        |
| Pastrimi i tepihëve me fshesë elektrike pa zhurmë  | D                      |
| Fshirja e korridoreve dhe pastrimi i tyre me leckë të njomë  | D-SN                   |
| Pastrimi i sipërfaqeve me leckë të lagur (sipërfaqet e forta përveç atyre të drunjtave)  | D-SN                   |
| Pastrimi i dyshemeve me leckë të njomë   | D                      |
| Pastrimi i dyerve, dorëzave dhe tabakave të xhamit   | D                      |
| Lustrimi i instalimeve nga metali  | J                      |
| Fshirja e pluhurit nga pikturat, tabelat e shpalljeve, shenjave dhe mobilieve  | J                      |
| Fshirja e pluhurit nga parvazet e dritareve, mureve, plafonëve gypave, tablove dhe dritave   | J                      |
| Larja dhe terja e dritareve (brenda dhe jashtë)  | M2                     |
| Larja e tepihëve me shampun  | M6-SN                  |
| Pastrimi i mureve, dyerve dhe orendive nga druri   | M3                     |

|   |       |
|---|-------|
| Pastrimi i njollave në mure, dyerve dhe tepihëve  | D-SN  |
| <b>ZYRAT, KLASAT DHE SALLAT E KONFERENCAVE</b>  |       |
| Zbrazja dhe pastrimi i shportave të letrave   | D-SN  |
| Fshirja dhe pastrimi i dyshemeve me leckë   | D-SN  |
| Pastrimi i dyshemeve me leckë të lagur  | D     |
| Pastrimi i dyshemeve të drurit me leckë të njomë  | D     |
| Pastrimi i tepihëve me thithëse elektrike, thithëse elektrike pa zhurmë   | D     |
| Pastrimi i pluhurit në të gjitha mobilet, parvazet e dritareve, pajisjet/makinat për zyre dhe ngrohësit   | J     |
| Pastrimi dhe dezinfektimi i telefonave, kompjuterëve dhe pajisjeve tjera  | J     |
| Pastrimi nga pluhuri i dritareve, mureve, orendive nga druri, plafonëve, trupave ndriçues, tablove, dyerve, dritareve   | J     |
| Larja dhe terja e dritareve (të brendshme dhe të jashtme)   | M2    |
| Larja e tepihëve me shampon   | M6-SN |
| Larja e mureve, dyerve dhe orendive nga druri   | SN    |
| Larja e mobilieve   | SN    |
| Pastrimi i njollave nga tapiceria e mobilieve   | SN    |
| Pastrimi i njollave nga të gjitha muret dhe orenditë e drurit   | SN    |
| Pastrimi i njollave në tepihë   | SN    |
| <b>DHOMAT E FURNIZIMIT DHE DEPOT</b>  |       |
| Zbrazja dhe pastrimi i shportave të letrave   | D-SN  |
| Fshirja dhe pastrimi i dyshemeve me leckë   | D-SN  |
| Të mos këtë mbeturina në asnjë hapësirë   | D     |
| Të fshihet dhe të pastrohet me leckë dyshemeja  | J     |
| Pastrimi i pluhurit në të gjitha mobilet, tablove dhe dritave   | J     |
| Pastrimi sipas nevojës në të gjitha muret dhe orenditë e drurit   | SN    |
| <b>HAPËSIRAT E PUNËTORIVE DHE HAPËSIRAT TEKNIKE (KËTO HAPËSIRA DUHET PASTRUAR NË BASHKËPUNIM DHE NËN MBIKËQYRJEN E PERSONELIT PROFESIONAL TEKNIK JO VETËM PASTRUESI/ /JA)</b> |       |
| Fshirja dhe pastrimi i pluhurit me leckë në dysheme   | J     |
| Të mos këtë mbeturina në asnjë hapësirë   | D     |
| Fshirja e pluhurit nga pajisjet, mobilet, tablove dhe dritave   | J     |
| Pastrimit sipas nevojës i mureve dhe dyerve, dritareve  | SN    |
| <b>HAPËSIRAT E PLLATOVE, SHKALLËVE TË JASHTME, PARKINGJEVE, TROTUAREVE, DRENAZHEVE</b>  |       |

|   |       |
|---|-------|
| Fshirja dhe pastrimi i pluhurit dhe mbeturinave të ndryshme   | D- SN |
| Të mos ketë mbeturina në asnjë hapësirë   | D- SN |
| Shenjëzimi i vend parkimeve, pastrimi dhe largimi i mbeturinave dhe gjelbërimeve  | SN    |
| <b>HAPËSIRAT E GJELBËRUARA</b>  |       |
| Fshirja dhe pastrimi nga mbeturinat, gjethet dhe frytet e drunjtëve   | D-SN  |
| Të mos ketë mbeturina në asnjë hapësirë të gjelbëruar   | D     |
| Rregullimi, ujitja, dizajnimi i luleve në hapësira të gjelbëruara dhe në vazo (saksia)  | J-SN  |
| <b>FASADAT, TERASAT, KULMET</b>   |       |
| Fshirja dhe pastrimi nga mbeturinat, gjethet dhe frytet e drunjtëve si dhe papastërtia e ndryshme Të mos ketë mbeturina në asnjë hapësirë Pastrimi i mureve, dritareve, xhamave dhe pjesëve tjera të fasadave dritaret, xhamat dhe pjesët e fasadës, pjesa e jashtme duhet pastruar duke shfrytëzuar mekanizimin – vinçin apo ashensorin e posaçëm për pastrim të fasadave për ndërtesat e larta së paku çdo ( 6 ) muaj dhe sipas nevojës edhe ma shpesh varësisht nga gjendja. | SN    |

## 9. MATERIALI PËR MIRËMBAJTJE HIGJENIKE

Materialin harxhues për realizimin e mirëmbajtjes higjienike duhet ta sigurojë vetë kompania. I tërë materiali duhet të jetë i kualitetit të lartë dhe klasit të parë.

Ofruesi i shërbimeve, para se të fillojë aplikimin e materialit, duhet të sjellë mostrat për aprovim me shkrim nga AK. Pa aprovimin e materialit nga AK, nuk lejohet përdorimi i të njëjtit për mirëmbajtje higjienike.

Minimumi i materialeve të nevojshme për pastrim të cilat ofruesi i shërbimeve duhet siguruar pandërprerë dhe në sasi të nevojshme dhe të mjaftueshme pavarësisht nga shpenzimi – harxhimi i tyre janë:

- Letër tualeti, dy-shtresore e bardhë e kualitetit të lartë.
- Letër për duar e trashë, e bardhë, e gjerë (dyfishi i tualet letrës) e kualitetit të lartë, varësisht nga mekanizmat e instaluar për mbajtjen e letrës.
- Sapun të lëngshëm.
- Dezodorant për urinare, tableta dezinfektuese, plastika – goma të shpuara.
- Sapun dezodorant (përfshirë edhe shportën) për guaca.
- Dezinfektues të tualeteve.
- Dorëza plastike për pastruesit.
- Detergjent për pastrimin e dritareve.
- Detergjent për pastrimin e dyshemesë.
- Detergjent për pastrimin e tepihëve.
- Qeska për të gjitha llojet e kontejnerëve - shportave të mbeturinave.



- Qeska për shportat e letrave.
- Dezodorans për kabinete, zyre, salla.
- Detergjent për pastrimin e Pllakave.
- Kovë për pastrimin e dyshemesë.
- Makina për pastrim dhe lustrim të pllakave të mermerit – granitit.
- Fshesë elektrike pa zhurmë me pjesët përbërëse.
- Kripë për shkrirjen e borës, akullit.
- Kripë me rërë për shkrirjen e borës, akullit.
- Fshesa për kopsht.
- Brusha të ndryshme për pastrime të tualeteve.
- Vegla të ndryshme për punët e gjelbërimit, lulet, rrethojat e gjalla, bari, etj.
- Lecka për pastrimin e dyshemesë.
- Sfungjerë (shpuzë).
- Lecka për pastrimin e dritareve dhe mobilie.
- Polir (shkëlqyes) për mobile.
- Polir (shkëlqyes) për metal dhe mesing.
- Lecka për pastrimin e dritareve.
- Polir për dysheme.
- Detergjent për qeramikë.
- Detergjent për heqjen e njollave.
- Brusha për pastrimin e pluhurit.
- Kocka dezinfektuese për guaca.
- Pajisje dhe makineri për pastrimin dhe sipas nevojës larjen e fasadës me të gjitha pjesët përbërëse të saja si dritareve dhe elementeve tjera të pjesës së jashtme dhe brendshme të fasadës.

## 10. INFORMATA SHITESË

Sipërfaqet e prezantuara të ndërtesës paraqesin sipërfaqet e ndërtesave me të gjitha zonat, të gjitha nivelet, terasat, bodrumet, anekset e ndërtesave ( si janë: pikat e sigurimit, parkingjet , gjelbërimet, shtigjet e këmbësorëve etj.) .

Është mirë që, gjatë fazës së tenderimit, të parashihet vizita e ndërtesave për ofertuesit me ç'rast do të kenë mundësi të shohin ndërtesat, sistemet dhe pajisjet të instaluar si dhe verifikimin e sipërfaqeve të hapësirave, para dorëzimit të ofertave.

## 2. MIRËMBAJTJA E VETURAVE

Autoriteti Kontraktues është duke identifikuar ofruesit e shërbimeve që do të kenë kapacitetin për të ofruar shërbime të mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve.

### Lënda e Kontratës është e ndarë në 9 Pjesë ( Lot).

**Pjesa 1: Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve:**

**Shkoda Fabia , Xhip Tiguan, VW Pollo, Golf-Plus dhe Toureg**

| <b>SERVISIMI DHE MIRËMBAJTJA E AUTOMJETEVE: SHKODA FABIA, XHIP TIGUAN, VW POLLO, GOLF-PLUS DHE TOUREG</b> |                                  |                |                     |
|---|----------------------------------|----------------|---------------------|
| NR  | PËRSHKRIMI I AUTOMJETEVE         | VITI PRODHIMIT | SASIA E AUTOMJETEVE |
| 1   | SHKODA FABIA AMBIENTE 1.4 DIESEL | 2009           | 1                   |
| 2   | Xhip Tiguan Sport 2.0 TDI Diesel | 2009           | 1                   |
| 3   | VW-POLLO 1.4 Benzinë             | 2004           | 1                   |
| 4   | GOLF -Plus 2.0 TDI Diesel        | 2004           | 1                   |
| 5   | TOUAREG 2.5 TDI Diesel           | 2006           | 1                   |

**Pjesa 2: Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve:**

**Peugeot,Toyota, Fiat Ducatom, Hyundai dhe VW TOURAN**

| <b>SERVISIMI DHE MIRËMBAJTJAE AUTOMJETEVE: PEUGEOTTE, TOYTA, FAT DUCATOM, HYUNDAI DHE VËWTOURAN</b> |  |                |                     |
|---|--|----------------|---------------------|
| NR  | PËRSHKRIMI I AUTOMJETEVE                               | VITI PRODHIMIT | SASIA E AUTOMJETEVE |
| 1   | Peugeot 206 Sedan 1.4 ,Diesel                          | 2010           | 1                   |
| 2   | Toyota 4 Runner 2982cm <sup>3</sup> , Diesel           | 1999           | 1                   |
| 3   | Fiat Ducatom 35,2.3JTD/ 2287cm <sup>3</sup> , Diesel   | 2013           | 1                   |
| 4   | HYUNDAI IX35 2.0 CRDI , Diesel                         | 2010           | 1                   |
| 5   | VW TOURAN 1.9 TDI VW T - 1896 cm <sup>3</sup> , Diesel | 2003           | 1                   |

**Pjesa 3: Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve:**

**Hyundai, Mitsubishi , Opel Astra , Opel Insignia,Tyuora Rav.**

**SERVISIMI DHE MIRËMBAJTJA E AUTOMJETEVE: HYUNDAI, MITSUBISHI, OPEL ASTRA, OPEL INSIGNIA, TYUORA RAV**

| NR | PËRSHKRIMI I AUTOMJETEVE                    | VITI PRODHIMIT | SASIA E AUTOMJETEVE |
|----|---|----------------|---------------------|
| 1  | Hyundai Santa fe , 2188 cm3- Diesel         | 2007           | 1                   |
| 2  | Mitcubishi Lancer, 1798 cm3 - Benzin        | 2008           | 1                   |
| 3  | Opel Astra , 1686 cm3 - Diesel              | 2012           | 1                   |
| 4  | Opel Insignia , 1796 cm3 - benzin, manual   | 2009           | 1                   |
| 5  | Toyota Rav 4, 4x4 , 1995 cm3 dizell, manual | 2005           | 1                   |

**Pjesa 4: Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve:**

**Hyundai Lc, Mitsubishi Outlandet , Toyota Avensis dhe Peugeot**

**SERVISIMI DHE MIRËMBAJTJA E AUTOMJETEVE: HYUNDAI LC, MITSUBISHI OUTLANDET, TOYOTA AVENSIS DHE PEUGEOT**

| NR | PËRSHKRIMI I AUTOMJETEVE                   | VITI PRODHIMIT | SASIA E AUTOMJETEVE |
|----|--|----------------|---------------------|
| 1  | Hyundai Lc 1.5 -1493 cm/dizel/             | 2005           | 1                   |
| 2  | Mitsubishi Outlander 2.2 DID 2179cm/dizel/ | 2009           | 1                   |
| 3  | Toyota Avensis 2.0 - 1998cm/dizel          | 1998           | 1                   |
| 4  | Peugeot 508 2.0 HDI - 1997cm/ dizel/       | 2012           | 1                   |

**Pjesa 5: Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve:**

**Shkoda, Polo,Toyota Rav,Toyota Land Cruiser dhe Mercedes -Benz**

**SERVISIMI DHE MIRËMBAJTJA E AUTOMJETEVE: SHKODA, POLO, TOYOTA RAV, TOYOTA LAND CRUISER DHE MERCEDES-BENZ**

| NR | PËRSHKRIMI I AUTOMJETEVE                    | VITI PRODHIMIT | SASIA E AUTOMJETEVE |
|----|---|----------------|---------------------|
| 1  | Shkoda Super Aktive 1.6 TDI 1598 cm3,Dizel  | 2013           | 1                   |
| 2  | Polo 1.9 SDI                                | 2013           | 1                   |
| 3  | Toyota RAV4 2.0 D4d 5v                      | 2004           | 1                   |
| 4  | Toyota LAND CRUISER 3.0 D-4D                | 2004           | 1                   |
| 5  | Mercedes-Benz 906Ka 504x4 2148 cm3          | 2008           |                     |
| 6  | Mercedes-Benz 416 CDI VDDM Sprinter 2686cm3 | 2004           |                     |

## Pjesa 6: Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve:

### Nissan Patrol, KIA Ceed, KIA Rio dhe Peugeot

| SERVISIMI DHE MIRËMBAJTJA E AUTOMJETEVE: NISSAN PATROL, KIA CEED, KIA RIO DHE PEUGEOTE |   |                |                     |
|--|---|----------------|---------------------|
| NR   | PËRSHKRIMI I AUTOMJETEVE  | VITI PRODHIMIT | SASIA E AUTOMJETEVE |
| 1  | Nissan Patrol GL (Y61), 3000 cm <sup>3</sup> , DIZEL, Manual, 4x4 | 2008           | 1                   |
| 2  | KIA Ceed, 1600 cm <sup>3</sup> , DIZEL, Manual                    | 2012           | 1                   |
| 3  | KIA Rio, 1248 cm <sup>3</sup> , BENZIN, Manual                    | 2012           | 1                   |
| 4  | Peugeot 301, 1560 cm <sup>3</sup> , DIZEL, Manual                 | 2014           | 1                   |

## Pjesa 7: Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve:

### Chevrolet Epica, Hyundai Acent, Hyundai Getz dhe Hyundai Acent

| SERVISIMI DHE MIRËMBAJTJA E AUTOMJETEVE: CHEVEOLET EPICA, HYUNDAI ACENT, HYUNDAI GETZ DHE HYUNDAI ACENT |                             |                |                     |
|---|-----------------------------|----------------|---------------------|
| NR  | PËRSHKRIMI I AUTOMJETEVE    | VITI PRODHIMIT | SASIA E AUTOMJETEVE |
| 1   | Chevrolet Epica 2.0 Benzinë | 2007           | 1                   |
| 2   | Hyundai Acent 1.5 Diesel    | 2005           | 1                   |
| 3   | Hyundai Getz 1.4 Benzinë    | 2006           | 1                   |
| 4   | Hyundai Acent 1.5 Benzinë   | 2005           | 1                   |

## Pjesa 8: Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve:

### SEAT IBIZA, OPEL ASTRA, CHEVROLET

| SERVISIMI DHE MIRËMBAJTJA E AUTOMJETEVE: SEAT IBIZA, OPEL ASTRA, CHEVROLET |  |                |                     |
|--|--|----------------|---------------------|
| NR   | PËRSHKRIMI I AUTOMJETEVE   | VITI PRODHIMIT | SASIA E AUTOMJETEVE |
| 1  | SEAT IBIZA, Modeli: 6J IBIZA 1.4 I STYLE Benzin,                     | 2010           | 1                   |
| 2  | OPEL ASTRA, Modeli: Astra, 1796 cm <sup>3</sup> Benzin               | 2009           | 1                   |
| 3  | CHEVROLET, Modeli: Aveo 1206 cm <sup>3</sup> Benzin                  | 2009           | 1                   |
| 4  | Chevrolet Cruze 4D Base, 1598 cm <sup>3</sup> , Benzin-nga pjesa I I | 2009           | 1                   |

## Pjesa 9: Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve:

**SERVISIMI DHE MIRËMBAJTJA E AUTOMJETEVE: CHEVROLET CRUZE, VOLKSWAGEN, SHKODA FELICIA, VË GOLF, PEUGEOT HDI DHE PEUGEOT XT**

| NR | PËRSHKRIMI I AUTOMJETEVE                      | VITI PRODHIMIT | SASIA E AUTOMJETEVE |
|----|---|----------------|---------------------|
| 2  | Volkswagen Passat 1896 cm <sup>3</sup> Dizel  | 2003           | 1                   |
| 3  | Shkoda Felicia 1896 cm <sup>3</sup> Diesel    | 2001           | 1                   |
| 4  | VW Golf, 1896 cm <sup>3</sup> . Diesel        | 2003           | 1                   |
| 5  | Peugeot 306 HDI 1997 cm <sup>3</sup> , Diesel | 2001           | 1                   |
| 6  | Peugeot 306 XT 1598 cm <sup>3</sup> - Benzin  | 2001           | 1                   |

Të gjitha automjetet janë në pronësi të Autoritetit Kontraktues

Specifikimet e hollësishme janë paraqitur në Përshkrimin e Çmimeve ne Excel për të 9 Pjesët (lot), të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj dosjeje të tenderit.

| LOT 1  |  |               |       |   |  |   |   |  |  |   |
|--|--|---------------|-------|---|--|---|---|--|--|---|
| Pjesa 1: Servisimi dhe Mirëmbajtja e Automjeteve |  |               |       |   |  |   |   |  |  |   |
| A  | SERVISIMI RREGULLT   | Njesia matese | Sasia | Mercedes 180 C 2.0, (Benzin) viti i prodhimit 2002, kapacitetit 1998 cm <sup>3</sup> 1 veturë | Audi A6 3.0 Dizel viti i prodhimit 2012, kapacitetit 2967 cm <sup>3</sup> , 1 veturë | Audi A6 3.0 TDI Dizel, viti i prodhimit 2004, kapacitetit 2967 cm <sup>3</sup> 1 Veturë | Pollo SDI Dizel 1.9, viti i prodhimit 2004, kapacitetit 1896 cm <sup>3</sup> , 2 vetura | Shkoda Rapid 1.6, viti i prodhimit 2016, kapacitetit 1596 cm <sup>3</sup> , 3 vetura | Shkoda Rapid 1.6, viti i prodhimit 2013, kapacitetit 1596 cm <sup>3</sup> , 1 veturë | Shkoda Fabia prodhimit kapacitetit 18 vetur |
| 4  | Servisimet e rregullta sipas Pliantit te servismive te rregullta për çdo 10.000 km te kaluara. Te jepet çmimi total për servisim e rregullt duke përfshirur vetëm:<br>Vaji i motorit<br>1 Filteri i Vajit<br>Filteri i Nafës<br>Filteri i Ajrit<br>Filteri i Kilmës.<br>Puna e Dorës | Komplet       | 1     | 1   | 1  | 1   | 2   | 3  | 1  | 1   |
| 6  | Servisimet e rregullta sipas Pliantit te servismive te rregullta për çdo 10.000 km te kaluara. Te jepet çmimi për identifikimin e prishjeve të mundshme. Defektatza duke kontrolluar vetëm:<br>Sponat<br>Frenat<br>Dritat<br>Rrotat<br>Trapin e parë<br>2 Trapin e mbramë            | Komplet       | 1     |   |  |   |   |  |  |   |
| 7  | Reglizatza   | Komplet       | 1     |   |  |   |   |  |  |   |
| 8  | A - Gjithesaj (1-3):   |               |       |   |  |   |   |  |  |   |

Shërbimet e Servisimit dhe mirëmbajtjes se automjeteve kryhen ne hapësirat e servisit të ofruesit të shërbimeve.

Ofruesi i shërbimeve duhet ti japë përparësi riparimeve ose mirëmbajtjes së këtyre automjeteve në raport me automjetet në pronësi të personave të tjerë juridik dhe fizik.

Duhet te përdoren vetëm pjesë dhe materiale te prodhuesit (GenuineManufacturer'sparts). Në rast se pjesët dhe materialet e automjeteve nga prodhuesi (GenuineManufacturer'sparts) nuk janë në dispozicion, (p.sh. për automjetet e vjetra), ofruesi i shërbimeve duhet të informojë menaxherin e kontratës i cili mund të bie dakord që të instalohen pjesë standarde ekuivalente si OEM (OriginalEquipmentManufacturer), i cili dakordim duhet të shqyrtohet dhe miratohet nga ekspert teknik të Autoritetit Kontraktues.

Pjesët e vjetra/te zëvendësuar do të jetë pronë e Autoritetit Kontraktues që shfrytëzojnë kontratën dhe do të duhet të kthehen nga Ofruesi i Shërbimeve së bashku me inventarët e pjesëve të

zëvendësuar. Të gjitha pjesët që kërkojnë zëvendësim duhet të zëvendësohet vetëm me pjesë origjinale dhe **garancioni i pjesës** së zëvendësuar duhet të depozitohet tek Autoriteti Kontraktues.

## **PËRSHKRIMI I SHËRBIMEVE NDIHMËSE**

Orari i servisimeve të rregullta do të jetë në përputhje me rekomandimet e prodhuesit të automjeteve.

Autoriteti Kontraktues që shfrytëzon kontratën do të vë në dispozicion brenda ditës, për ofruesin e shërbimit çdo automjet për të cilin kërkohet servisi dhe mirëmbajtja e rregullt. Autoriteti Kontraktues (AK) do të përpiqet që të vë automjetet në dispozicion për servisim dhe mirëmbajtje të rregullt në intervale të caktuar për të shmangur mbingarkesën. Megjithatë, për arsye operationale, disa automjete mund të mos jenë në dispozicion për servisimin e rregullt dhe AK nuk është i obliguar që të vë automjete në dispozicion.

Ofruesi i shërbimeve do të njoftohet nga AK se kur nevojitet servisi i rregullt i një automjeti. AK është përgjegjës për transportimin e automjetit nga lokalet e veta të lokali i ofruesit të shërbimeve dhe për të marrë atë pas përfundimit të shërbimeve.

Në rast të defektit rrugor ofruesi i shërbimeve është përgjegjës për marrjen e automjetit nga rruga dhe për transportimin e automjetit tek lokali i tij dhe pas përfundimit të shërbimeve për dorëzimin e automjetit tek AK. Për transportimin e automjetit nga vendi i prishjes deri në punëtorinë – servisin e kryerësit të shërbimeve nuk do të faturohet shpenzimet e transportit, ato duhet të kalkulohen në çmimin e pjesëve me rastin e ofertimit.

Riparimet do të përfundojnë në kohën më të shkurtër të mundshme, kur janë në dispozicion, pjesët rezerve që janë në depo të ofruesit të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve duhet të bëjë përpjekje maksimale që në depon e tij të ketë rezerva të mjaftueshme të pjesëve rezervë. Aty ku një pjesë nuk është në depo, ofruesi i shërbimit do të konfirmojë me shkrim tek AK për datën kur pjesa do të jetë në dispozicion. Në këto raste afatet kohore për disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit dhe kryerjen e shërbimeve do të jetë brenda 10 ditë.

Çmimet e ofruara për servisimet e rregullta duhet të përfshijë të gjitha aktivitetet që janë dhënë në Specifikacionin e pjesëve dhe aktivitetet për servisimin e rregullt të automjeteve që është bazë për kalkulimin e çmimeve për servisimet e rregullta. Numri i orëve të punës do të përfshihet në çmimin e servisimit të rregullt dhe pjesëve të ndërrimit. Nëse gjatë servisimit të rregullt vërehet se është e nevojshme që të ndërrohet ndonjë pjesë e cila nuk është përfshirë në servisimin e rregullt ofruesi i shërbimeve duhet të njoftojë AK. Pasi që AK të marrë njoftimin nga ofruesi i shërbimeve, AK do ta lajmërojë ofruesin e shërbimeve me shkrim nëse duhet të ndërrojë atë pjesë apo jo. Nëse po, ofruesi i shërbimeve do të faturojë atë pjesë sipas çmimit për njësi të dhënë në listën e çmimeve për pjesë rezervë në Tabelat e Excel-it - B, C dhe D.

Çmimet e ofruara për mirëmbajtje dhe pjesë rezervë (Tabela B e Excel-it), çmimet e ofruara për riparime dhe ngjyrosje (Tabela C e Excel-it) dhe çmimet e ofruara për pjesë të karrosierisë (Tabela D e Excel-it) duhet të përfshijnë çmimet për pjesët rezerve plus çmimet për orë të punës.

Nuk do të pranohet fatura e veçantë për orë pune.

**Specifikacioni i pjesëve dhe aktivitetet për servisimin e rregullt të automjeteve që është bazë për kalkulimin e çmimeve për servisimet e rregullta (kategoria A) për të gjitha Pjesët (Lot):**

| NR | PËRSHKRIMI   | SERVISIMI I RREGULLTË PAS ÇDO 10.000 KM TË KALUARA PO/JO | SERVISIMI I RREGULLTË PAS ÇDO 20.000 KM TË KALUARA PO/JO |
|----|--|--|--|
| 1  | Kontrollo rripat e sigurisë  | PO   | PO   |
| 2  | Kontrollo funksionin e të gjitha llambave treguese dhe paralajmëruese                          | PO   | PO   |
| 3  | Kontrollo fshirëset e xhamave përpara dhe mbrapa si dhe funksionin e tyre                      | PO   | PO   |
| 4  | Kontrollo funksionimin e frenit të dorës nëse nevojitet rregulloje                             | PO   | PO   |
| 5  | Kontrollo të gjitha dritat   | PO   | PO   |
| 6  | Nxirri rrotat dhe kontrollo jastëkët e frenave   | PO   | PO   |
| 7  | Kontrollo sistemin e ftohjes për ndonjë rrjedhje   | PO   | PO   |
| 8  | Kontrollo funksionin e gomave, gërvishtje si dhe për dëmtime. Shtypjen atmosferike             | PO   | PO   |
| 9  | Kontrollo sistemin e frenimit. Riparoje nëse nevojitet   | PO   | PO   |
| 10 | Lyej të gjitha nyjet, kontrollo dyert/mbylljen, dorëzat e dyerve si dhe kapakun e karburanteve | JO   | PO   |
| 11 | Kontrollo baterinë startuese, pastro dhe lyej me yndyrë terminalet                             | PO   | PO   |
| 12 | Kontrollo tolerancën e valvuleve   | JO   | PO   |
| 13 | Ndërroje filtrin e karburanteve  | JO   | PO   |
| 14 | Kontrollo funksionin e filterit të ajrit, pastroje por nëse nevojitet ndërroje                 | PO   | PO   |
| 15 | Kontrollo funksionin e filterit të klimës, pastroje por nëse nevojitet ndërroje                | PO   | PO   |
| 16 | Kontrollo gjendjen e rripave të motorit nëse nevojitet ta ndërroj                              | PO   | PO   |
| 17 | Kontrolloje dhe mbushje pompën hidraulike të timonit   | PO   | PO   |
| 18 | Kontrolloje papuçen e ndërruesit të shpejtësive dhe rregulloje nëse nevojitet                  | PO   | PO   |
| 19 | Kontrollo vajin e sistemit të frenimit   | PO   | PO   |
| 20 | Ndërroje vajin e motorit   | PO   | PO   |

|    |  |    |    |
|----|--|----|----|
| 21 | Ndërroje filtrin e vajit   | PO | PO |
| 22 | Kontrolloje dhe mbushe me vaj nëse nevojitet ndërruesin e shpejtësive  | PO | PO |
| 23 | Kontrollo vajin e reduktorit   | PO | PO |
| 24 | Ndërroje vajin e reduktorit  | JO | PO |
| 25 | Kontrolloje vajin e diferencialit para dhe mbrapa                      | JO | PO |
| 26 | Ndërroje vajin e diferencialit para dhe mbrapa- nëse është e nevojshme | JO | PO |
| 27 | Kontrollo sistemin e gypave të frenimit, timonit nga dëmtimet          | PO | PO |

### Shënim:

Të gjitha rubrikat e plotësuara me **PO** në këtë Specifikacion - plan të servisimit të rregulltë nënkupton që duhet të ndërrohen ose të kontrollohen dhe këto pjesë faturohen sipas çmimeve për njësi të dhënë në Lista e çmimeve – Tabelat në Excel A - servisimi i rregullt.

### **B: MIRËMBAJTJA DHE PJESËT REZERVË**

- Në çmimin e pjesëve rezervë të automjeteve duhet të llogariten shpenzimet që lindin si rezultat i pjesëve mekanike, elektrike për rregullimin e automjetit.
- Në çmim duhet të llogaritet së bashku çmimi i pjesës (ÇP) dhe çmimi i shërbimit (ÇSH) për secilin furnizim /shërbim/ punë që është përshkruar te **Lista e çmimeve- Tabelat në Excel B - MIRËMBAJTJA DHE PJESËT REZERVË**.
- Garancioni i pjesëve mekanike dhe elektrike lidhur me ndrrimin e pjesës kërkohet të jenë së paku një vit nga data e pranimit/dorëzimit të pjesës në gjendje të rregullt nga zyrtari përgjegjës në AK.
- Pjesët që i ndërrohen veturave duhet të jenë të reja nga prodhuesi, të jenë të ambalazuara dhe paketuara, të kenë përshkrimin në paketimin/ambalazhimin e pjesëve.
- Në çdo fushë të zbrazët vendosni çmimet në të kundërtën oferta e juaj nuk do të vlerësohet dhe do të shpallet e papërgjegjshme.
- Fushat me shkronjat **n/a** (nuk aplikohet) nuk duhet të plotesohen nga Operatorët Ekonomik.
- Çmimet e dhëna të jenë fikse me të gjitha taksat, tatimet dhe detyrimet e aplikuara me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.

### **C: RIPARIM, NGJYROSJE**

- Në çmimin e riparimit të pjesëve të limarisë që janë në veturë duhet të llogariten riparimi i pjesëve të limarisë, puna, montimi, ngjyrosja si dhe të gjitha shpenzimet tjera që lindin si rezultat i riparimit të pjesëve të limarisë së automjetit.
- Garancioni i riparimit të pjesëve të limarisë dhe ngjyrosjes kërkohet të jenë së paku një vit nga data e pranimit/dorëzimit të riparimit të pjesës të limarisë dhe ngjyrosjes në gjendje të rregullt nga zyrtari përgjegjës në AK.
- Në çmim duhet të llogaritet çmimi i shërbimit (ÇSH) për secilin shërbim/punë që është përshkruar te **Lista e çmimeve- Tabelat në Excel C - RIPARIM, NGJYROSJE**, oferta financiare të dosjes së tenderit.



- Në çdo fushë të zbrazët vendosni çmimet në të kundërtën oferta e juaj nuk do të vlerësohet dhe do të shpallet e papërgjegjshme.
- Fushat me shkronjat **n/a** (*nuk aplikohet*) nuk duhet të plotësohen nga Operatorët Ekonomik.
- Çmimet e dhëna të jenë fikse me të gjitha taksat, tatimet dhe detyrimet e aplikuara me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.

#### **D: PJESET E KARROSERISË**

- Në çmimin e pjesëve të karroserisë të automjeteve duhet të llogariten shpenzimet që lindin si rezultat i pjesëve mekanike, elektrike për rregullimin e automjetit.
- Në çmim duhet të llogaritet së bashku çmimi i pjesës (ÇP) dhe çmimi i shërbimit (ÇSH) për secilin furnizim /shërbim/ punë që është përshkruar te **Lista e çmimeve- Tabelat në Excel D - PJESET E KARROSERISË**.
- Garancioni i pjesëve të karroserisë, kërkohet të jenë së paku një vit nga data e pranim/dorëzimit të pjesës në gjendje të rregullt nga zyrtari përgjegjës në AK.
- Pjeset që i ndrrohen veturave duhet të jenë të reja nga prodhuesi, të jenë të ambalazuara dhe paketuara, të kenë përshkrimin në paketimin/ambalazhimin e pjesëve.
- Në çdo fushë të zbrazët vendosni çmimet në të kundërtën oferta e juaj nuk do të vlerësohet dhe do të shpallet e papërgjegjshme.
- Fushat e me shkronjat **n/a** (*nuk aplikohet*) nuk duhet të plotësohen nga Operatoret Ekonomik.
- Çmimet e dhëna të jenë fikse me të gjitha taksat, tatimet dhe detyrimet e aplikuara me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.

### 3. FURNIZIM ME PELET

Autoriteti Kontraktues (AK), (të shkruhet emri i plotë i AK \_\_\_\_\_), është duke identifikuar furnizuesit potencial, të cilët do të kenë kapacitetet e nevojshme për furnizim me Pelet.

Furnizimet do të bëhen në Adresat e Institucioneve të specifikuar më poshtë:

#### LISTA DHE ADRESA E INSTITUCIONEVE PËR FURNIZIM ME PELET

| NR RENDOR | EMRIN E INSTITUCIONIT<br>(ÇERDHE, SHKOLLË FILLORE<br>E MESME E ULËT, SHKOLLA<br>FILLORE E MESME E LART,<br>BIBLIOTEKE, ZYRE E<br>VENDIT, QMF, QPS, ETJ.) | ADRESA E PLOTË<br>(RRUGA, VENDI) | NJËSIA MATËSE<br><b>TONELATA</b> | SASIA |
|-----------|--|----------------------------------|----------------------------------|-------|
| 1         |  |                                  |                                  |       |
| 2         |  |                                  |                                  |       |
| 3         |  |                                  |                                  |       |
| 4         |  |                                  |                                  |       |
| 5         |  |                                  |                                  |       |
| 6         |  |                                  |                                  |       |
| 7         |  |                                  |                                  |       |

Furnizuesit do të jenë përgjegjës për furnizimin dhe shpërndarjen e plotë të Peletit ashtu siç kërkohet në këtë listë.

Rreziku i humbjes ose dëmtimit eventual, para se të bëhet pranimi i mallit nga ana e AK, nga ndonjë shkak/arsye do të jetë dhe do të kompensohet nga furnizuesi deri në kohën e dorëzimit të furnizimeve në depot apo vendin e caktuar nga AK.

AK, do të refuzojnë produktin, duke njoftuar me shkrim Furnizuesin për çdo dërgesë të Peletit i cili dështon në përmbushjen e specifikimeve minimale të cilësisë dhe sasisë së përcaktuar në këtë specifikim teknik.

#### SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

##### SASIA

|                                 |   |
|---------------------------------|---|
| <b>Paketimi</b>                 | Në thasë plastike sipas standardit ENplus A1 dhe A2 me peshë ≤30 kg               |
| <b>Përbërja</b>                 | Peleti të jetë 70 % dru ahur dhe 30% pishë  |
| <b>Lagështia</b>                | ≤10 %   |
| <b>Dimensionet</b>              | diametri Ø 6 mm, gjatësia 31.5 mm ≤ L ≤ 40 mm dhe dendësia >600 kg/m <sup>3</sup> |
| <b>Mbetja e pluhurit</b>        | ≤2%   |
| <b>Vlera më e ulët kalorike</b> | ≥4.6 kEh/kg   |
| <b>Gazrat e lira</b>            | emitim neutral i CO <sub>2</sub>  |

|                                       |   |
|---------------------------------------|---|
| Peleti duhet të jetë sipas standardit | ISO 17225 2   |
| Mbetja e hirit                        | në 815°C të jetë 0,5% ≤ 1,5%  |
| Të dhëna tjera                        | Karakteristikat e Peletit duhet të jenë të shtypura në ambalazh dhe të jenë të dukshme mirë |

## 4. FURNIZIM ME DRU

Autoriteti Kontraktues (AK), (\_\_\_\_\_), është duke identifikuar furnizuesit potencial, të cilët do të kenë kapacitetet e nevojshme për furnizim me lëndë djegëse - Drunjë.

Furnizimet do të bëhen në Adresat e Institucioneve të specifikuar më poshtë:

### LISTA DHE ADRESA E INSTITUCIONEVE PËR FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE - DRUNJË

| NR RENDOR | EMRIN E INSTITUCIONIT<br><br>(ÇERDHE, SHKOLLË FILLORE E MESME E ULËT, SHKOLLA FILLORE E MESME E LARTË, BIBLIOTEKË, ZYRE E VENDIT, QMF, QPS, ETJ.) | ADRESA E PLOTË<br><br>(RRUGA, VENDI,) | NJËSIA MATËSE<br><br>METËR<br>HAPËSIRË* | LLOJI I DRURIT: |       |
|-----------|---|---------------------------------------|---|-----------------|-------|
|           |   |                                       |   | 1. AHU.         | SASIA |
| 1         |   |                                       |   | 1 = .. m        |       |
|           |   |                                       |   | 2 =.. m         |       |
| 2         |   |                                       |   |                 |       |
| 3         |   |                                       |   |                 |       |
| 4         |   |                                       |   |                 |       |
| 5         |   |                                       |   |                 |       |
| 6         |   |                                       |   |                 |       |
| 7         |   |                                       |   |                 |       |

**\*(1 metër hapësirë = palosje e mirë e drunjëve, duke i plotësuar zbrazëtirat në mes të drunjëve të trasha me drunjë më të hollë në 1m Gjatësi x 1m Gjerësi x 1m Lartësi)**

Furnizuesit do të jenë përgjegjës për furnizimin dhe shpërndarjen e plotë të lëndëve djegëse - Drunjëve ashtu siç kërkohet në këtë listë.

AK, do të refuzojë produktin, duke njoftuar me shkrim Furnizuesin për çdo dërgesë të lëndëve djegëse – Drunjëve, e cila dështon në përmbushjen e specifikimeve minimale të cilësisë dhe sasisë së përcaktuara në këtë specifikim teknik. Matja e sasisë do bëhet për metër hapësirë pasi të jenë renditura në radhe me lartësi 1 m, gjerësi 1 m, dhe gjatësi varësisht nga hapësira në dispozicion. Prezenca e përfaqësuesit të AK e domosdoshme gjatë palosjes dhe matjes.

Operatori Ekonomik, duhet të dëshmoj se drunjët janë të prerë legalisht dhe të jenë të vulosura nga organi kompetent.

Rreziku i humbjes ose dëmtimit eventual, para se të bëhet pranimi i lëndëve djegëse - drunjëve nga ana e AK, për çfarëdo arsye eventuale që do të jetë, do të kompensohet nga furnizuesi deri në kohën e dorëzimit të furnizimeve dhe pranimit nga ana e AK në depot apo vendin e caktuar.

| SPECIFIKIEMET TEKNIKE TË DETYRUESHME |   |
|--------------------------------------|---|
|                                      | SASIA e përgjithshme ..... m hapësirë   |
| Lëndë djegëse - Drunjë               | .....m <sup>hapësirë</sup> drunjë Ahu dhe<br><br>.... .m <sup>hapësirë</sup> drunjë Bungu / Qarri   |
| Lloji i drurit                       | Ahu ose Bung / Qarr (50% / 50% apo proporcion tjetër, i cili duhet të plotësohet) (drunjët duhet të jetë kompakt dhe i formës rrethore, jo i ndarë (qarë) për së gjati.   |
| Trashësia                            | Minimum Ø 15 cm   |
| Gjatësia mesatare                    | 100 cm (± 3 cm)   |
| Vjetërsia e prerjes                  | 6 - 12 muaj para furnizimit   |
| Palosja dhe Matja                    | Matja e sasisë së drunjëve do të bëhet pasi të jenë të renditura dhe palosura mirë (duke plotësuar zbrazëtitrat në mes të drunjëve të trasha me të holla) në radhë një metër lartësie e gjerësi, kurse gjatësia varet prej terrenit sa lejon, në vendin e përcaktuar nga AK |
| Shkurtim/Sharrimi i drunjëve         | Çdo 33 cm (± 1 cm) ose trungu me gjatësi 100 cm ± 3 cm të shkurtohet një herë apo dy herë (ose në sa pjesë të jetë e nevojshme duke ju përshtatur stufave) dhe të qahet në diametrin e kërkuar max. ø--cm) - e specifikon njësia kërkuese                                   |
| Lagështia                            | ≤ 20 %  |
| Shënim tjetër                        | <u>Lëndët djegëse - Drunjët duhet të jenë të prera dhe të thata, të gatshme për stufë. Sharritja, palosja në m-hapësirë, transporti dhe shkarkimi duhet të përfshihen në çmim.</u>  |

### Shembull i një liste të kërkesave të veçanta për Furnizim me Dru

|  |   |   |
|--|---|---|
| Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik     | <b>Kërkesa X</b><br>Operatori Ekonomik duhet ti ofroj dëshmi bindëse Autoritetit Kontraktues që nuk ka të ngritur ndonjë procedurë për dëme pyjore ne Agjencinë Pyjore te Kosovës dhe se nuk ka obligime të pakryera ndaj Agjencionit nga kontratat e mëhershme | <b>Dëshmia X</b><br>Një Vërtetim i lëshuar nga Agjencioni Pyjor i Kosovës (i lëshuar në 3 mujorin e fundit para datës së publikimit të njoftimit për kontratë) - kopje. |
| Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale | <b>Kërkesa X</b><br>Operatori Ekonomik duhet të jetë i licencuar nga Agjencia e Pyltarisë së Kosovës për prerje dhe transport të drunjëve për kryerjen e punimeve në pyje dhe toka pyjore.  | <b>Dëshmia X</b><br>Kopje e Licencës (e vlefshme)   |

## 5. FURNIZIM ME MATERIAL HIGJENIK

### PARATHËNIE

Operatorët Ekonomik fitues do të jenë përgjegjës për menaxhimin e plotë të furnizimit me material higjienik sipas specifikimeve teknike të detyrueshme të paraqitura në tabelat më poshtë.

Rreziku i humbjes apo dëmtimit, të materialit higjienik nga cilido shkak do të jetë mbi Furnizuesin dhe do të përballohet nga Furnizuesi deri në kohën kur materiali higjienik të dorëzohet në pronësi të AK.

AK kanë të drejtë të refuzojnë çdo dërgesë të materialit higjienik, i cili dështon në përmbushjen e specifikimeve minimale të cilësisë të përcaktuara në këtë specifikim teknik.

Objekti i kontratës është i ndarë 2 lote:

**Lot 1.** Furnizim me letër higjienike

**Lot 2.** Furnizim me materiale të ndryshme higjienike

*Më poshtë është dhënë përshkrimi i specifikave teknike për të dy lotet:*

**Lot 1. Furnizim me letër higjienike**

| LOT 1. FURNIZIM ME LETËR HIGJENIKE |  |               |
|------------------------------------|--|---------------|
| NR                                 | PËRSHKRIMI I ARTIKULLIT  | NJËSIA MATËSE |
| 1                                  | Letër (rollne, për duar, për aparat standard 100% celulozë (sipas aparateve)   | Copë          |
| 2                                  | Letër kuzhine (e trashë në rollne, përafërsisht 30cm e gjerë; min. 700gr; paketimi 2x1)  | Komplet       |
| 3                                  | Letër për duar (Z-palosje, letër e bardhë. një fije - letër të cilësisë së fortë; rreth 220-250 fletë për paketë; e dizajnuar që të përputhet me bombolë me vrimë)   | Copë          |
| 4                                  | Letër për duar dy shtresore formë Z (për aparat automatik me 200 fletë; 100% celulozë e bardhë; madhësia e fletëve 24x22cm; paketimi 1/1 e dizajnuar për kuti metal) | Copë          |
| 5                                  | Letër për tualet rollne (rollne: letër cilësore, e butë me dy shtresa; ngjyrë e bardhë; në paketim 24x1)   | Copë          |
| 6                                  | Letër tualeti (rollne: letër cilësore, e butë me dy shtresa; ngjyrë e bardhë; në paketim 8+2)  | Komplet       |
| 7                                  | Letër tualeti (rollne: letër cilësore, e butë me dy shtresa; ngjyrë e bardhë; në paketim 16x1)   | Komplet       |
| 8                                  | Letër tualeti (rollne: letër cilësore, e butë me dy shtresa; ngjyrë e bardhë; në paketim 24x1)   | Komplet       |
| 9                                  | Faculeta letre, për kuzhine; katrore tre palëshe; ngjyre e bardhë)   | Copë          |
| 10                                 | Faculeta letre, dekoruese me ngjyra; në paketim 100x1)   | Copë          |
| 11                                 | Faculeta letre, të lagura e me kapak mbyllës; në paketim 1x80)   | Copë          |
| 12                                 | Faculeta letre, të lagura; në paketim 1x24)  | Komplet       |
| 13                                 | Faculeta letre, të lagura; në paketim 1x74)  | Copë          |
| 14                                 | Faculeta letre, 100% celulozë; ngjyrë e bardhë; bakteriologjikisht e pastërt; dimensionet 28x28cm; në paketim 1/100)   | Copë          |

|    |  |         |
|----|--|---------|
| 15 | Vata higjienike mujore (për gjininë femërore; në paketim 1/10) | Copë    |
| 16 | Pampersa (për fëmijë 3-5 kg; në paketim 1/40)                  | Paketim |
| 17 | Pampersa (për të rritur 65-80 kg; në paketim 1/15)             | Paketim |

## Lot 2. Furnizim me materiale të ndryshme higjienike

| LOT 2. FURNIZIM ME MATERIALE TË NDRYSHME HIGJIENIKE |  |               |
|---|--|---------------|
| NR  | PËRSHKRIMI I ARTIKULLIT  | NJËSIA MATËSE |
| 1   | Aparat (sprej) automatik (komplet për ambient të brendshëm; +2 bateri AA; +1 sprej 250ml)  | Copë          |
| 2   | Spërkatës ajri automatik 250 ml (AirWick ose të ngjashëm që zgjat deri në përafërsisht 60 ditë)  | Copë          |
| 3   | Aparat metali për letër të duarve (me tërheqje për letrat në formë "Z")  | Copë          |
| 4   | Aparat metali për letër toaleti (për rollne me peshë nga 250gr. deri 300r.)  | Copë          |
| 5   | Aparat metali për shampon të duarve (për 500ml. deri 750ml.)   | Copë          |
| 6   | Detergjent për larjen e rrobave (në paketim 3 kg; larja në 30°C, 40°C, 60°C dhe 90°C; përbërësit: 5-15% surfaktant anionik, agjent zbardhues të bazuar në oksigjen, zeolite; 5% surfaktant joanionik, sapun, polikarboksilate, fosfonate; enzime, zbardhues optikë, parfume (linalool, limonene, hexyl cinnamal) në mashat e makinës larëse nuk duhet të formohet gëlqere) | Copë          |
| 7   | Detergjent i lëngët për larjen e rrobave (paketim 3 litërsh; përbërësit: 5-15% anionic surfactants; <5%)   | Copë          |
| 8   | Detergjent për heqjen e njollave të rrobave (450 ml)   | Copë          |
| 9   | Dezinfektues për toalet (WC guacë) (min. 750ml, përbërësit: hipokloriti i natriumit 4.5g për 100g. <5%, agjent zbardhues me bazë klor (hipoklorit natriumi), surfaktantë jo-jonikë, surfaktant kationik, sapun, parfum)  | Copë          |
| 10  | Pastrues çeliku inox min. 500ml (sprej) (preparat pastrues për kuzhinë; heq yndyrën dhe njollat në kuzhinë; përmban <5% surfaktantë jo-jonikë)   | Copë          |
| 11  | Pastrues i shumëfishtë (cif ose ekuivalent) (krem dhe mikrokristale lemon; min. 500 ml.; që përdoret për banjo, kuzhina, lavamanë qeramike; përmban: 5-15% surfaktant anijonik, <5% surfaktant katijonik, sapun, parfum, limoni apo tjetër)  | Copë          |
| 12  | Pastrues tualeti dhe freskues (50 - 55) g/copë (1x4); me shkëlqim dhe me erë të freskët; përbërësit: > 30% surfaktantë anionikë, 5-15% surfaktantë jo-jonikë, <5% agjentë zbardhues bazuar në klor, aromë limoni apo tjetër)   | Copë          |
| 13  | Detergjent - pastrues për dysheme, pllaka ose qeramikë (min. 1 litër; përbërësit: <5% surfaktant jo-jonik, surfaktant jo-jonik, parfum limoni apo tjetër)  | Copë          |
| 14  | Detergjent për xhama (sprej) (min. 750 ml, i përdorshëm për sipërfaqe të ndryshme dhe xhama; që thahet shpejtë dhe nuk lë njolla (vija); mund të përdoret në sipërfaqe si: qelq, pasqyra, dritare, interier makinash, dru; përbërësit: <5% surfaktant anionik, përmban parfum)   | Copë          |

|    |  |      |
|----|--|------|
| 15 | Detergjent për xhama (sprej) (min. 750 ml, i përdorshëm për sipërfaqe të ndryshme dhe xhama; që thahet shpejtë dhe nuk lë njolla (vija); mund të përdoret në sipërfaqe si: qelq, pasqyra, dritare, interier makinash, dru; përbërësit: <5% surfaktant anionik, përmban parfum)                 | Copë |
| 16 | Deodorant për urinar (që vepron kundër aromës së pakëndshme; i tretshëm në ujë; lëshon agjentet e pastrimit çdoherë kur përdoret urinari dhe shmang bllokimin; kontrollon shkallën e gelqeres, shkallën e urinës)  | Copë |
| 17 | Deodorant për fontanën e toaletit (WC) (parandalon shkallën e gelqeres; siguron aromë të freskët)  | Copë |
| 18 | Pastrues sprej për myk (500 ml; me mekanizëm pompë; përbërësit: dezinfektant -<5% hipoclorit de sodium, surfaktant neionic)  | Copë |
| 19 | Pastrues dysHEMEJE për laminat dhe parket (min. 1 litër, përbërësit: <5% surfaktantë jo-jonik, parfum)   | Copë |
| 20 | Preparat për heqjen e njollave nga pëlhura ose ngjashëm (min 1 litër, përbërësit: zbardhues me bazë klori dhe aromë)   | Copë |
| 21 | Acidi klorhidrik për amvisëri ("varikin-zbardhues"; min. 1 l.)   | Copë |
| 22 | Acid për pastrim thartirë 2HCl ("thartirë"; min. 1 l.)   | Copë |
| 23 | Sapun i lëngët me glicerinë min. 500ml (i përshtatshëm për çdo lloj lëkure dhe pH duhet të jetë neutrale e lëkurës dhe e testuar dermatologjikisht)  | Copë |
| 24 | Pastë - gel (detergjent për pastrimin e duarve, min. 600 gr)   | Copë |
| 25 | Shampon për makina 5 kg (detergjent i bazuar në 15% substanca aktive; i rekomanduar për operacionet manuale të larjes; PH neutrale, delikate dhe e sigurt për çdo lloj bojë; heq papastërtinë për shkak të smogut, yndyrës, vajit dhe lloçit duke lënë sipërfaqe të pastërta dhe të ndritshme) | Copë |
| 26 | Detergjent për makinë të enëve (paketim 1.5kg; përbërësit: 3 deri 5% fosfat, 5% zbardhues në bazë oksigjeni, 5% surfaktant jo-jonik, 5% parfum (limon), enzime (proteaza, amilaza)   | Copë |
| 27 | Shampon për enë min. 450 ml. (përbërja mesatarisht 20% aditiv)   | Copë |
| 28 | Shkëlqyes për makinën e larjes se enëve 450 ml   | Copë |
| 29 | Shampon për enëlarëse industrial (përbërësit në përputhje me rregulloren e detergjentit EG 648/2004: 5-15% EDTA, <5% fosfonate, alkalizues, elektrolite, <5% polikarboksilate dhe bartës të papastërtisë)  | Copë |
| 30 | Shkëlqyes për enëlarëse industrial (i konceptuar për makina automatike të enëve që mënjanojnë shfaqjen e shenjave dhe njollave të çdo lloji, i aplikueshëm me ujë të butë dhe të fortë)  | Copë |
| 31 | Pastrues për furrë, skarë dhe aspiratorë (përbërësit: surfakants lëndet tensioaktive jojonike, natrium hidroksid, sodium; paketimi 650 ml.)  | Copë |
| 32 | "Vim" ose ekuivalent, i ngurtë (pluhur) 500ml.   | Copë |
| 33 | "Arf" ose ekuivalent i lëngët 500ml.   | Copë |
| 34 | Tufë e vogël me fije pambuku (mop) (për pastrim të ambienteve të brendshme; montohet në mbajtës të   | Copë |

|    |   |      |
|----|---|------|
|    | posaqëm; pesha minimum 250gr; përbërja e materialit 100% pambuk)  |      |
| 35 | Fshesë me fije sintetike (gjerësia e brushës 30-45cm; bishti min. 130cm; gjatësia e fijeve sintetike min. 8cm)  | Copë |
| 36 | Fshesë me lopatë plastike të vogël  | Copë |
| 37 | Fshesë dorëz e thjeshtë (me fije kashte me bisht të shkurtër)   | Copë |
| 38 | Fshesë dorëz e thjeshtë (me fije kashte me bisht të gjatë)  | Copë |
| 39 | Fshesë dorëz e thjeshtë e plastikës (me fije plastike me bisht të shkurtër)   | Copë |
| 40 | Fshesë dorëz e thjeshtë e plastikës (me fije plastike me bisht të gjatë)  | Copë |
| 41 | Mbajtës për tufë të vogël (që mund të montohet; materiali plastikë)   | Copë |
| 42 | Gomë për dysheme (gjerësia e gomës 30-50cm)   | Copë |
| 43 | Bisht alumini standard (në të cilin mund të vendosen pajisjet nga pozicionet 34, 40 e 41; dimensionet 2x1m)   | Copë |
| 44 | Gjoker papuçe me material pambuk 100 % me bisht   | Copë |
| 45 | Gjoker papuçe me material pambuk 100 % pa bisht   | Copë |
| 46 | Gjoker me fije të gjata tip balerinë (me bisht të gjatë; min. 180 cm)   | Copë |
| 47 | Shtrydhëse dyshemeje me gome të dyfishtë 45 cm me bisht me gjatësi min. 1 m   | Copë |
| 48 | Mop i pambukut (300 gr me bisht druri me gjatësi min.1 m; pastron dyshemenë)  | Copë |
| 49 | Spërkatëse (me rezervuar min. 900 ml)   | Copë |
| 50 | Enë (bokall) i plastikës II.  | Copë |
| 51 | Enë e fortë e plastikës (për disa përdorime; madhësitë e përafërta me diametër 22cm e thellësi 3.5cm)   | Copë |
| 52 | Brusha për toilet (WC) me mbajtës plastic   | Copë |
| 53 | Goma thithëse për pastrim të gypave   | Copë |
| 54 | Lopatë për pastrim të dyshemesë (materiali plastikë, gomë në pjesën e poshtme të lopatës; kapak për mbyllje të lopatës; bishti i lopatës (alumin) me mbajtëse plastike (dorëz), gjatësia min. 1m; pjesë plastike të dhëmbëzuar në pjesën e sipërme të lopatës për "kullim" të fshesës | Copë |
| 55 | Gomë për xham (me mbajtëse dore; gjerësia e gomës 30-50cm)  | Copë |
| 56 | Bisht për fshirje të merimangave 3 deri 5 m. i gjatë  | Copë |
| 57 | Kovë për xhoker për tufë me dy ujëra (kovë për xhoker me ndarje për ujë të pastër dhe të papastër; me kapacitet 8l + 6l, material polipropilen)   | Copë |
| 58 | Kofë me shtrydhëse (kapaciteti min.12 l.)   | Copë |
| 59 | Kovë plastike 20 lit. (me kapak për ujë)  | Copë |
| 60 | Kovë për xhama me dy ujëra (për pastrimin e xhamave; madhësia në cm: 45x36x26; materiali polipropilen)  | Copë |
| 61 | Leckë për xhama (leckë (multi-touch) për pastrim të xhamave nga të gjitha papastërtitë; përbërësit  | Copë |



|    |   |         |
|----|---|---------|
|    | poliester dhe poliamid; absorbimi 200%; dimensionet 40x40 cm (+/- 2cm))   |         |
| 62 | Leckë mikrofibër për pastrimin e monitorëve dhe kompjuterëve (paketimi min. 4 copë)   | Paketim |
| 63 | Leckë magjike 100% mikrofibër (dimensionet e përafërta min. 68cm × min 48cm; heq njollat me yndyrë pa përdorur pastrues nuk lë gjurmë të fshirjes)  | Copë    |
| 64 | Leckë për dritare dhe vetura (dimensionet e përafërta min. 66cm × min. 43cm x 0.2cm; pastron dritaret, pasqyrat dhe sipërfaqet e tjera nga xhami)   | Copë    |
| 65 | Shpuzë për pastrim në kuzhinë (shpuza duhet të ketë shtresën e vrazhdtë dhe sungjerin, paketimi min. 4 copë dhe max. 5 copë)  | Paketim |
| 66 | Leckë shpuze (sungjer) (min. paketim 1x3); dimensionet min. 18x20 cm; absorbues i mirë i ujit për pastrim të sipërfaqeve të kuzhinës)   | Paketim |
| 67 | Shpuzë (sungjer) me dy anë të buta për larjen e automjeteve   | Copë    |
| 68 | Tel kuzhine për enë (1/10)  | Paketim |
| 69 | Lecka mikrofazor për polirim (tharje) të gotave   | Copë    |
| 70 | Tela për enë nga inox   | Copë    |
| 71 | Shportë për mbeturina min 20l. (për zyre; materiali plastikë)   | Copë    |
| 72 | Shportë për mbeturina 10l. (materiali plastikë)   | Copë    |
| 73 | Shportë për mbeturina plastike me mekanizëm të hapjes me këmbë (min. 20l.)  | Copë    |
| 74 | Shporta PVC për bartjen e mbeturinave (me dy rrota; me kapak; 120l.)  | Copë    |
| 75 | Shporta PVC për bartjen e mbeturinave (me dy rrota; me kapak; 240l.)  | Copë    |
| 76 | Pajisje me 4 rrota për pastrim + 2 kova 25lit. nga plastika + mekanizëm për shtrydhjen dhe lecka me bisht   | Copë    |
| 77 | Dorëza për pastrim (dorëza shumë përdorimëshe të papërshkueshme nga uji; materiali gomë; madhësia: S, M, L)   | Palë    |
| 78 | Dorëza lateks jo sterile (paketimi 1/100 copë)  | Paketim |
| 79 | Dorëza higjienike të trasha (materiali plastikë, të trasha e të mbrojtura nga uji; madhësia S, M, L dhe XL)   | Palë    |
| 80 | Thasë mbeturinash 35 litra (10 copë/komplet; qeset e mbeturinave duhen të jenë biodegradueshme në natyrë pas një periudhe prej 24-36 muaj nga data e prodhimit; qeset duhen të jenë 100% të riciklueshme)   | Copë    |
| 81 | Thasë mbeturinash 120 litra (10 copë/komplet; qeset e mbeturinave duhen të jenë biodegradueshme në natyrë pas një periudhe prej 24-36 muaj nga data e prodhimit, qeset duhen të jenë 100% të riciklueshme)  | Copë    |
| 82 | Thasë mbeturinash 150 litra (10 copë/ komplet; qeset e mbeturinave duhen të jenë biodegradueshme në natyrë pas një periudhe prej 24-36 muaj nga data e prodhimit, qeset duhet të jenë 100% të riciklueshme) | Copë    |
| 83 | Thasë të letrës për thithëse elektrike (dimensionet sipas thithëseve elektrike në përdorim)   | Copë    |

|    |  |      |
|----|--|------|
| 84 | Helm për minj (në formë të katrorëve (llokumëve); 200 gr.)   | Copë |
| 85 | Sprej / Insekticid dhe akaricidi i lëngshëm (min. 500 ml; për pastrim universal)   | Copë |
| 86 | Sprej për insekte 400 ml.  | Copë |
| 87 | Pluhur insekticid 100gr për largimin e milingonave, insekt, buburrecat, pleshtat dhe insektet e tjera zvarritje në zonat që jetojnë nëpër depo | Copë |
| 88 | Acid kokërr nga kripa I kg. (për zbllokim të gypave të kanalizimit)  | Copë |

## 6. SIGURIMI I OBJEKTEVE

### SIGURIMI I OBJEKTEVE

| NR | FUSHËVEPRIMI  |
|----|---|
| 1  | <p>Kompania do të sigurojë rojtare sigurie të pajisur si duhet dhe të trajnuar mirë, në vendet e caktuara nga Autoriteti Kontraktues. Mbikëqyrësi i kompanisë do të garantojë që rojet e sigurisë të kryejnë detyrën kryesore të mbrojtjes së punonjësve dhe pronës së AK. Kompania do të sigurojë të gjitha materialet dhe pajisjet e nevojshme të punës dhe të mbikëqyrjes për të kryer shërbimet në të gjitha aspektet dhe garanton se të gjitha shërbimet do të kryhen me kohë dhe në mënyrë profesionale. Kompania do të caktojë një menaxher të këtij projekti që të monitorojnë kualitetin e shërbimeve që ofrohen dhe të shqyrtojë dështimet apo mangësitë në ofrimin e shërbimeve që i ofrohen AK.</p>   |
| 2  | <p>Kompania duhet të ofrojë gjithë çka nevojitet, në përputhje me sigurinë e pa armatosur, për të mbrojtur punonjësit e AK, pronën e AK, dokumentacionin e AK dhe mbrojtjen tjetër sipas kërkesave nga zyrtaret përgjegjës pranë Autoritetit Kontraktues.</p> <p>Këto shërbime përfshijnë vend-qëndrimet e sigurimit me përgjegjësitë në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Administrimi i procedurave të sigurisë në lokacionin e objekteve të AK.</li> <li>• Kontrollimi në hyrje i personave, automjeteve dhe pronës tjetër.</li> <li>• Vëzhgimi i lokacionit (në këmbë ose me automjet).</li> <li>• Identifikimi dhe raportimi i shkeljeve të sigurisë.</li> <li>• Mirëmbajtja e dosjeve që kanë të bëjnë me dokumentacionin e sigurisë.</li> <li>• Asistimi i personelit të AK në situata emergjente.</li> <li>• Garantimi i veprimit të shpejtë për parandalimin apo minimizimin e humbjeve nga aksidentet, zjarri, dëmtimet në pronë, rreziqet e sigurisë, shkeljet e sigurisë dhe veprimet e dyshimta.</li> <li>• Informimi mbi ngjarjet e veçanta që ndodhin në tërë objektin dhe pronën.</li> </ul> <p>Rojtaret e sigurisë që punojnë duhet të paraqiten në punë me uniformat e siguruar nga kompania. Uniforma do të identifikojë qartë punonjësën si roje sigurimi që punon për kompaninë, duke përfshirë kartelën e identifikimit me fotografi. Uniforma duhet të jetë e rregullt, e pastër, e hekurosuar dhe të prezantojë pamje profesionale.</p> <p>Rojtaret e sigurisë asnjëherë nuk duhet të braktisin objektin gjatë turnit të tyre.</p> <p>Kompania duhet të sigurojë të gjitha uniformat, kartelat e identifikimit dhe pajisje tjera të nevojshme për kryerjen e detyrës.</p> |
| 3  | <p>Ofruesi i Shërbimeve duhet të garantojë se personeli i tyre do të kryejnë shërbime në përputhje me përcaktimet e kontratës, në interesin me të mirë të AK. Në të njëjtën kohë, Ofruesi i Shërbimeve duhet të garantojë të gjitha ndërtesat, hapësirat dhe të mirat materiale të AK do të jenë të sigurta dhe të mbrojtura nga vjedhja, dëmtimi, zjarri apo rreziqet tjera.</p>   |
| 4  | <p>Roja duhet të drejtojë komunikacionin në objektet e AK duke evituar parkimin e veturave në vendet ku është e ndaluar parkimi i veturave.</p>   |
| 5  | <p>Kompania duhet të mbajë librin e evidencës (regjistrimit se të dhënave) për çdo person që hyn dhe del nga objektet e AK.</p>   |
| 6  | <p>Kompania duhet të mbikëqyrë gjithë pasurinë në të gjitha objektet e AK duke ndaluar çdo person që tenton të vjedhë ose keqpërdorë ketë pasuri dhe duhet të respektojë të gjitha shkresat, vendimet, udhëzimet e pranuar nga zyrtaret përgjegjës në AK.</p>   |
| 7  | <p><b>Angazhimi i rojeve shtesë</b></p> <p>-kompania duhet çdo herë të jete e gatshme për ofrimin e rojeve shtesë.</p> <p>-angazhimi i rojeve shtesë bëhet vetëm me kërkesë të personit përgjegjës në AK</p>  |

|    |   |
|----|---|
| 8  | <p><b>Zëvendësimi i rojeve</b></p> <p>-Zëvendësimi i rojeve bëhet vetëm me njoftim dhe aprovim paraprak nga AK</p> <p>-Koordinimi mes rojeve duhet të bëhet nga mbikëqyrësi i grupit i cili caktohet nga kompania</p> <p>-Udhëzimet e përcaktuara për rojet duhet të jenë të njohura paraprakisht.</p>  |
| 9  | <p>Ofruesi i Shërbimeve duhet të ketë parasysh që në AK nuk është i instaluar sistemi i alarmit, por duhet të instalohen nga Ofruesi i Shërbimeve i cili do të shpallet fitues. AK nuk do ti kërkojë ne shfrytëzim pas përfundimit të kontratës me Ofruesin e Shërbimeve, por gjatë ekzekutimit të kontratës ne shfrytëzim me pagës ne çmim të përbashkët për njësi ore, ku në çmim të kalkulohet dhe vendosja e sistemit të alarmit.</p> <p><b>NËSE AK KA TË VENDOSUR SISTEMIN E ALARMIT, DUHET TË SQAROHET NE KËTË PJESË).</b></p>  |
| 10 | <p>Ofruesi i Shërbimeve gjate realizimit te kontratës do te <b>respektoj Ligjin e Punës në fuqi si dhe Ligjin për Shërbime Private të Sigurisë 04/L-004</b>, të Republikës së Kosovës</p>   |
| 11 | <p>Autoriteti Kontraktues gjate realizimit te kontratës gëzon te drejtën qe nëse vjen deri te hapja e ndonjë Qendre te re, te kërkoj nga Ofruesi i Shërbimeve qe shërbimet e sigurimit ti kryej edhe ne qendrat e hapura sipas kushteve te kontratës. Çmimi i pagesës për këto qendra do te jete çmimi për njësi i orës se shërbimeve sipas kontratës. Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues gëzon te drejtën e kërkesës nga Kryesi i shërbimeve për ndërprerjen e kryerjes se shërbimeve te sigurimit ne rast te mbylljes se ndonjërës nga Qendrat qe janë pjese e specifikacionit teknik te kësaj dosje te tenderit, së paku 30 ditë para mbylljes së qendrës.</p> |

**Në rast se AK vendos që të përcaktoj pagën minimale, AK duhet të vendos këtë kërkesë tek kapaciteti teknik dhe profesional**

Kërkesa:

Paga bruto mujore për një punëtor nga Ofruesi i shërbimeve kërkohe të jetë së paku bruto xx (te përcaktohet nga AK) për një muaj, për orarin javor prej 40 orëve.

Dëshmia:

Deklaratë e nënshkruar nga OE pjesëmarrës se punëtoreve do të ua paguaj pagën minimale së paku bruto xx (te përcaktohet nga AK) Euros, për orarin javor prej 40 orëve.

Shënim: në këto raste, në mënyre që të iu shmangemi çmimeve abnormale dhe çmimeve manipulative, AK mund të përcaktoj kërkesën si në vijim:

Kërkesa:

Ofertuesi së bashku me ofertë duhet të prezantojë një analizë financiare për pagën bazë xx (te përcaktohet nga AK) bruto të pasqyruara më të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212. OE duhet të paraqesë analize financiare me shkrim se si ka ardhur deri te çmimi përfundimtar e ku kjo analizë duhet të përfshijë së paku: Pagat bazë Bruto xx (te përcaktohet nga AK) për punëtorë, Pagesat shtesë për ndërrimet e natës dhe festat shtetërore, Pushimet vjetore, Trusti pensional, Fitimi i OE, TVSH-ja, Totali i ofertës

Dëshmia:

Analiza Financiare.

Shembull i kalkulimit

| #                           | TABELA E ÇMIMIT PER ORE KU PARASHIHEN TE GJITHA OBLIGIMET SIPAS LIGJIT TE PUNES |                            |   |             |  |
|-----------------------------|---|----------------------------|---|-------------|--|
| ORARI I PUNES 08:00 - 16:00 |   |                            |   |             |  |
| 1                           |   | <b>paga minimale bruto</b> |   |             |  |
| 2                           | paga minimale EURO  | <b>250</b>                 |   |             |  |
| 3                           |   |                            |   |             |  |
| 4                           | kushtet sipas ligjit te punes   | ore pune sipas kategorive  | Çmimi per nje ore pune sipas kategorise | Çmimet      | <b>koment</b>  |
| 5                           | ore dite - cmimi normal   | 176                        | 1.42                                    | 250.00      | paga bruto   |
| 6                           | ore nate - 30%  |                            | 0.43                                    | -           | nuk ka ore nate pasi qe orari per kete kategori eshte 8 - 16 |
| 7                           | ore festave - 50%   |                            | 0.71                                    | -           | te percaktohet numri i oreve te festave                      |
| 8                           | ore vikende - 50%   |                            | 0.71                                    | -           | te percaktohet numri i oreve te vikendeve                    |
| 9                           | pushim vjetor max. 20 dite sipas ligjit   | 13.33                      | 1.42                                    | 18.94       | 20 dite pushim vjetor  |
| 10                          | pushim mjeksor max. 20 dite sipas ligjit  | 13.33                      | 1.42                                    | 18.94       | 20 dite pushim mjeksor                                       |
| 11                          | Kontributi pensional i kompanise (5% punedhenesi)                               |                            |   | 12.50       | 5% i trustit ekstra  |
| 12                          |   |                            |   |             |  |
| 13                          | <b>paga per nje punetor ne muaj</b>   |                            |   | 300.38      |  |
| 14                          | <b>CMIMI TOTAL PER NJE ORE PUNE</b>   |                            |   | 1.71        |  |
| 15                          |   |                            | <b>TVSH</b>                             | 0.31        |  |
|                             | <b>TOTAL CMIMI PER NJE ORE PUNE ME TVSH</b>                                     |                            |   | <b>2.01</b> | cdo oferte nen ket cmim konsiderohet abnormal                |

## INFORMATA SHITESË

Llogaritja ne Listën e çmimeve, ne shembullin e bashkangjitur, është bërë veç e veç për çdo pikë, duke specifikuar numrin e orëve në ditë, numrin e ditëve në javë, numrin e orëve për muaj dhe për 36 muaj (3 Vite). AK ne varësi te kërkesave modifikon Listën.

I. Specifikimet përfshijnë orarin e fillimit të ruajtjes së objektit të Autoritetit Kontraktues,

- -Shërbimet e sigurimit fizik gjatë ditëve të punës, 8 orë (08.00-16.00)
- -Shërbimet e sigurimi fizik gjatë natës, 12 orë (19:00-7:00)
- -Shërbimet e sigurimi fizik pas përfundimit të orarit të punës dhe gjatë natës, 16 orë (16:00-8:00)
- -Shërbimet e sigurimit fizik gjatë 24 orëve, për vikend dhe gjatë festave, 24 orë (nga 08:00-08:00)
- -Shërbimet e sigurimit fizik gjatë 24 orëve, 24 orë( nga 08:00-08:00).

2. Specifikimi është bërë edhe për vendet dhe numrin e orëve që mbulohen me alarm. Orët e alarmit janë llogaritur kryesisht vetëm pas orarit te punës kur edhe aktivizohet alarmi, d.m.th.:

- -Shërbimet e sigurimit me alarm gjatë ditëve të punës, 16 orë(16:00-8:00)  
8:00 deri ne 16:00 është orari i punës përgjatë 5 ditëve të javës.
- -Shërbimet e sigurimit me alarm gjatë vikendit dhe festave, 24 orë ( nga 08:00-08:00)  
16:00 deri ne ora 8:00 janë llogaritur orët e alarmit përfshirë edhe ditët e vikendit kur nuk punohet, pra me 24 ore aktive me alarm.

(NËSE AK KA TË VENDOSUR SISTEMIN E ALARMIT te fshihen këto dy pozicione).

## SHEMBULL I PËRSHKRIMIT TE ÇMIMEVE

(Vendosë numrin e pozitive varësisht nga numri i njësive dhe kërkesat e AK)

| Pershkrimi I Cmimeve - Sigurimi fizik i objekteve |  |                  |                          |                              |                         |                                   |               |               |                   |
|---|--|------------------|--------------------------|------------------------------|-------------------------|-----------------------------------|---------------|---------------|-------------------|
| Nr.r  | Përshkrimi i pozitës   | Numri i pozitive | Numri i orëve            | Numri total i orëve për ditë | Numri I ditëve për muaj | Numri total i orëve për muaj dite | Çmimi për orë | Çmimi mujor   | Çmimi per 36 muaj |
|   |  | (a)              | (b)                      | (c) = (a) x (b)              | (d)                     | (e) = (c) x (d)                   | (f)           | (g)=(e) x (f) | (h)=(f) x 36      |
| 1   | Shërbimet e sigurimit fizik gjatë ditëve të punës                              | 1                | 8 orë (08.00-16.00)      | 8                            | 22                      | 176                               |               | -             | -                 |
| 2   | Shërbimet e sigurimit fizik gjatë natës  | 1                | 12 orë (19:00-7:00)      | 12                           | 30                      | 360                               |               | -             | -                 |
| 3   | Shërbimet e sigurimit fizik pas përfundimit të orarit të punës dhe gjatë natës | 1                | 16 orë (16:00-8:00)      | 16                           | 22                      | 352                               |               | -             | -                 |
| 4   | Shërbimet e sigurimit fizik gjatë 24 orëve, për vikend dhe gjatë festave       | 1                | 24 orë (nga 08:00-08:00) | 24                           | 8                       | 192                               |               | -             | -                 |
| 5   | Shërbimet e sigurimit fizik gjatë 24 orëve                                     | 1                | 24 orë (nga 08:00-08:00) | 24                           | 30                      | 720                               |               | -             | -                 |
| 6   | Shërbimet e sigurimit me alarm gjatë ditëve të punës                           | 1                | 16 orë (16:00-8:00)      | 16                           | 22                      | 352                               |               | -             | -                 |
| 7   | Shërbimet e sigurimit me alarm gjatë vikendit dhe festave                      | 1                | 24 orë (nga 08:00-08:00) | 24                           | 8                       | 192                               |               | -             | -                 |
| TOTALI (1-7)                                      |  |                  |                          |                              |                         |                                   |               |               |                   |
| -   |  |                  |                          |                              |                         |                                   |               |               |                   |

Ne këtë tabelë janë vendosur shënimet vetëm për nga një pozitë për secilin llojë të shërbimit, AK DUHET të vendosë numrin e pozitive për të cilat ka nevojë të kërkojë shërbimet e sigurimit, e po ashtu të përcaktojë llojin e shërbimeve që I duhen

### Shembull i një liste e kërkesave të veçanta për SIGURIM TE OBJEKTEVE

#### Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale

**Kërkesa 1:** OE duhet të posedoj licencën e lëshuar nga ARKEP për frekuencat për sistem radio komunikimi, lëshuar nga ARKEP konform rregullave të aplikueshme.

**Kërkesa 2:** OE duhet të posedoj licencën për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit fizik e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme – MPB ( Licenca duhet të jete valide sipas Ligjit për Shërbimet Private të Sigurisë nr. 04 L-004 ).

**Dëshmia 1:** Kopja e licencës valide për frekuencat për sistem radio komunikimi, lëshuar nga ARKEP.

**Dëshmia 2:** Kopja e Licencës mbi ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit fizik

## 7. SHËRBIME TË TRANSPORTIT

AK \_\_\_\_\_ është në fazën e identifikimit të Operatorëve Ekonomik që do të kenë kapacitetin për të ofruar Shërbimet e Transportit.

Operatori Ekonomik që do të përzgjidhet fitues duhet të jetë në gjendje të ofrojë këto shërbime konform këtyre specifikave që do të jenë pjesë e kontratës në mes të dy palëve nënshkruese.

Transporti duhet të bëhet me mjete të përshtatshme dhe të cilat duhet të jenë specifikisht të parapara për këto lloje të shërbimeve. Çdo vështirësi, rrezik apo dëmtim i mjetit që mund të bëhet, Ofruesi i shërbimeve duhet të jetë në gjendje t'i përballoj dhe të ofrojë zgjidhje adekuate, në mënyrë që nxënësit mos të mbesin pa transport.

Operatori Ekonomik fitues këto shërbime duhet t'i ofrojë në kohë dhe konform kërkesave dhe lëvizjeve të mundshme të orareve shkollore, në konsultim me personelin shkollor.

Çdo marrje e nxënësve dhe zbritje e tyre duhet të bëhet me kujdes të shtuar dhe në vende të përshtatshme në mënyrë që mos të vihen nxënësit në rrezik.

Mjeti i transportit duhet të jetë i regjistruar në njërin nga qendrat për regjistrimin e automjeteve dhe të ketë kontrollime teknike periodike ashtu siç është paraparë me Udhëzimin Administrativ Nr. 2008/13<sup>1</sup>. Mjetin e transportit të cilin e përdor operatori ekonomik, qoftë edhe ndërrim të tij, duhet ta njoftoj me shkrim autoritetin kontraktues, dhe gjithashtu mjeti i transportit në pjesën e jashtme të tij duhet të mos ketë ndonjë reklame.

Mjeti i transportit, duhet të ketë:

1. [shëno numrin e min dhe max] Ulëse;
2. Shenjën para dhe mbrapa të mjetit për transport të nxënësve;
3. Shoferi ta ketë të veshur një uniform identifikuese (p.sh. këmishë dhe kollare)
4. ...

Transporti i nxënësve duhet të bëhet në dy drejtime vajtje-ardhje, nga (shëno vendin) deri në (shëno shkollën) dhe anasjelltas dhe transporti i tyre do të realizohet për çdo ditë mësimi të mbajtur. Numri i nxënësve do të jetë (shëno numrin e nxënësve).

### SHËRBIMET E TRANSPORTIT PËR VITIN KALENDARIK JANAR-DHJETOR 2021

| NUMRI I LOT<br>N/A | NR I POZICIONEVE | PËRSHKRIMI   | NJËSIA<br>MATËSE | SASIA E<br>DITËVE<br>TË PUNËS | ÇMIMI<br>PËR DITË<br>PUNE | ÇMIMI<br>TOTAL |
|--------------------|------------------|--|------------------|-------------------------------|---------------------------|----------------|
|                    | I                | Transporti i nxënësve nga (vendi) deri në (shkollën) dhe anasjelltas | Ditë pune        | 184                           |                           |                |

<sup>1</sup> [https://www.mit-ks.net/repository/docs/UA-kontrolla\\_teknike\\_30\\_12\\_20081390670967.pdf](https://www.mit-ks.net/repository/docs/UA-kontrolla_teknike_30_12_20081390670967.pdf)

## 8. SHËRBIME TË VEÇANTA

### QËLLIMI

Përshkrimi i Shërbimeve të Veçanta - Shërbime Konsulente Individuale për nevojat e Autoritetit Kontraktues: \_\_\_\_\_ -

Duke pasur parasysh volumin e punëve që ka Zyra e Prokurimit në fushën e Prokurimit Publik, Autoriteti Kontraktues: \_\_\_\_\_ ka paraqitur nevojën për: **Angazhimin e Një (I) Konsulenti Individual për Prokurim Publik.**

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik që nga viti 2015 ka filluar implementimin dhe nga viti 2016 ka vene në përdorim Sistemin e Prokurimit Elektronik si një nga sistemet informative me të veçanta, me komplekse dhe me të ndjeshme në nivel qeveritar.

Ndërsa sipas Vendimit Nr. 91/2018, datë: 26.12.2018, KRPP-ja ka njoftuar Autoritetet Kontraktuese dhe Operatorët Ekonomik, se nga data: 01.01.2019 të gjitha procedurat e prokurimit (vlera e vogël, e mesme dhe e madhe), përveç atyre minimale dhe/ose procedurave të cilat nuk mund të zhvillohen përmes platformës, do të bëhen vetëm në formën elektronike.

Aktualisht sistemi i prokurimit elektronik është një nga sistemet informative qendrore me gjithëpërfshirëse dhe me përdorimin me të gjere nga të gjithë sistemet informative në nivel qeveritar.

Nga viti 2021 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Bordi i KRPP-së, në pajtim me Nenin 87, paragrafin 2, nën paragrafin 2.9 dhe nenin 91 paragrafin I të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, ka vënë në përdorim të dy module të reja në sistem të prokurimit elektronik, “Modulit për menaxhim të kontratës” dhe “Modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve”, aprovon dhe publikon: plotësim/ndryshimin e A01 Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik (RRUOP).

**Angazhimin e Një (I) Konsulenti Individual për Prokurim Publik**, është e domosdoshme për AK \_\_\_\_\_, pasi që KRPP-ja vazhdimisht sipas Ligjeve në fuqi dhe Udhëzuesit aktivizon modulet e reja, pasi që stafi i Autoritetit Kontraktues ka shumë pak njohuri rreth këtyre moduleve.

### OBJEKTIVI

Objektivat kryesore që synohen nëpërmjet këtij aktiviteti janë:

- Ngritja e kapaciteteve në zyrën e Prokurimit në AK \_\_\_\_\_, me përvojë dhe ekspertize të mjaftueshme për të dhënë këshilla në fushën e prokurimit, me theks të veçante përdorimi i platformës elektronike të prokurimit publik në të gjitha modulet përbërëse të saj, sidomos modulet e reja si Menaxhimi i Kontratës, ankandet, minutenderuesi dhe një nxitje rreth Parimeve të Prokurimit Publik - rritjes së transparencës, efikasitetit dhe llogaridhënies të AK.
- Gatishmëria e Zyrës së Prokurimit, për t’ju përgjigjur moduleve të reja të sistemit të prokurimit elektronik, përballë sfidave nga njësite kërkuese duke bërë trajnimin fizik të stafit për regjistrim në platforme dhe duke i vetëdijësuar që të funksionalizojnë përdorimin e moduleve.

## **TERMAT E REFERENCËS (TER)**

### **Nr. i konsulentëve:**

AK: \_\_\_\_\_ ka nevojë për **Një (1) Konsulenti Individual për Prokurim Publik**

### **Titulli i vendit të punës:**

Titulli i punës që do të ketë - **Konsulenti Individual për Prokurim Publik**

### **Drejtoria apo Njësia Kërkuese**

Njësia Kërkuese e cila ka nevojë për konsulentin e kërkuar është: **Zyra e Prokurimit pranë AK**  
\_\_\_\_\_.

### **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

Eksperti i përzgjedhur dhe angazhuar, në bashkëpunim të ngushtë me zyrtarin përgjegjës të prokurimit, ofron shërbime si në vijim:

- Bashkëpunon me stafin e AK për të identifikuar sukseset dhe sfidat në aktivitetet e prokurimit;
- Për atë që mundet, siguron se në specifikimet teknike nuk ka kufizime në konkurrencë;
- Këshillon njësitet kërkuese, për metoda dhe praktika përkatëse të prokurimit;
- Në bashkëpunim me Udhëheqësit e Njësive kërkuese dhe Udhëheqësin e Zyrës së Prokurimit organizon trajnimet në venin e punës për stafin kyç në lidhje me e-modulet e prokurimit;
- Ndihmon stafin përgjegjës si Menaxher të kontratës dhe Mbikëqyrës të drejtpërdrejt të Menaxherit të Kontratës, rreth detyrave dhe përgjegjësisë të tyre dhe këshillim në Sistemin e Prokurimit Elektronik;
- Ndihmon në përgatitjen e drafteve dhe Manuale sipas kërkesave të Zyrës së Prokurimit;
- Ndihmon në përgatitjen e Planit të Prokurimit bashkë me njësitet kërkuese – Drejtoritë dhe Zyrën e Prokurimit;
- Prodhon një raport mujor rreth ecurisë së punës së Zyrës së Prokurimit;

### **Kualifikimet / Kërkesat**

I.1. Të ketë të përfunduar Shkollimin Universitar ;

I.2. Të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune në fushën e prokurimit;

I.3. Të ketë certifikate të prokurimit publik

I.4. Konsulenti individual duhet të dorëzojë një metodologji dhe plan të punës për arritjen e objektivave të parapara në TeR

### **Dëshmia e kërkuar dokumentare për të gjitha Kërkesave:**

I.1. Kopja e Diplomës Universitare;



I.2. Kontratat e punës të lëshuara nga punëdhësit ose Letër referencë mbi përvojën e punës, si dhe të bashkëngjitet CV-ja e nënshkruar nga vetë personi.

I.3 Kopja e Certifikates

I.4 Metodologjia dhe plani i punës i hartuar nga Konlusenti

Kriteret, nën-kriteret, dhe sistemi i pikëve për vlerësimin e Propozimeve Teknike janë:

| Kualifikimet Minimale                              | Piket e parapara për këtë tender |
|--|----------------------------------|
| Përvojë specifike                                  | <b>20</b>                        |
| Përshatje e metodologjisë/planit të punës ndaj TeR | <b>50</b>                        |
| Kualifikimi  | <b>10</b>                        |
| Transferimi i njohurisë (opsionale)                |                                  |
| <b>Pikët totale</b>                                | <b>100</b>                       |

Nota teknike minimale Nt që kërkohet për të kaluar është **70** nga 100 pikë të mundshme.

Peshët që janë dhënë për Propozimet Teknike (PT) dhe Propozimet Financiare (PF) janë:  $PT = 70$  dhe  $PF = 30$

### **Orari i Punës, kohëzgjatja dhe vendi i performimit të pozitës:**

I angazhuari do të punojë dyzetë (40) orë në javë, prej të Hënës deri të Premten sipas orarit 08:00-16:00, brenda një periudhe gjashtë (6) mujore në AK \_\_\_\_\_.

### **Raportimi:**

Eksperti i kontraktuar i cili do të jete në mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të Menaxherit të kontratës, është i obliguar që të përgatis raporte të punës dhe aktiviteteve të tij në baza mujore dhe në përfundim të kontratës raport gjashtë mujor, në gjuhën shqipe. Raportet e punës dhe aktiviteteve do të jete subjekt i aprovimit nga ana e Menaxherit të Kontratës.

### **Akomodimi në zyrë:**

- Akomodimi në zyrë i një standardi të arsyeshëm dhe prej përafërsisht 10 metra katrorë për ekspertin do të sigurohet nga Autoriteti Kontraktues.
- Lehtësitë që do të sigurohen nga eksperti
- Eksperti duhet të jete i pajisur me pajisje adekuate (lap top).

### **Përfitimet e pritura:**

Angazhimi i ekspertit pranë Zyrës së Prokurimit është i domosdoshëm ku lehtëson punën brenda drejtorive dhe të stafit të AK, shton përkrahjen gjatë vlimit të aktiviteteve gjatë periudhës për përgatitjen e Planit të Prokurimit bashkë me njësitë kërkuese dhe Zyrën e Prokurimit.

## 9. DDD SHËRBIMET

### 9.1 DEZINSEKTIMI HAPËSINOR

#### HYRJE

Si ne shumicën e Komunave ne Republikën e Kosovës edhe ne Komunën e \_\_\_\_\_ në vazhdimësi prej viti në vit paraqiten sëmundje të ndryshme ngjitëse si: tularemia, ethet hemorragjike, ethet e Nilit Perëndimor, sëmundja e LYME-it dhe një numër i madh i sëmundjeve tjera ngjitëse të traktit digestiv dhe atij respirator. Një nga rrugët e përhapjes së këtyre sëmundjeve është edhe ajo e cila realizohet përmes vektorëve të cilët mund të jenë të ndryshëm: brejtës, insekte rrëshqitëse dhe insekte fluturuese si: mizat, mushkonjat etj.

Me qëllim të parandalimit të sëmundjeve që mund të shkaktojnë dëmtim të shëndetit të popullatës, Kuvendi Komunal (\_\_\_\_\_) ka paraparë aktivitete të ndryshme ne lëmin e shëndetit publik e një ndër to është edhe zbatimi sistematik i veprimeve të dezinfektimit hapësinor me qëllim të eliminimit apo sjelljes në kufijtë e tolerancës epidemiologjike të insekteve fluturuese mbi territorin e komunës tonë.

Përmes këtij projekti synohet parandalimi i përhapjes së sëmundjeve ngjitëse përmes vektorëve dhe përmirësimi i kualitetit të jetës për qytetaret e komunës tonë. Masat për eliminimin e mushkonjave sipas OBSH-së duhet të përfshijnë tretmanin me larvicid residual dhe spërkatjen hapësinore. Principi themelor i spërkatjes së suksesshme hapësinore është arritja e kontaktit maksimal në mes të insektit dhe insekticidit. Kjo më së miri arrihet nëse retë e aerosolit kanë madhësi optimale të grimcave (mjaf insekticid) dhe nëse kanë efikasitet të duhur sulmues. Për aksion efikas duhet të plotësohen disa kushte si: kushtet mikrometeorologjike, aplikimi i standardeve të parapara në kontekst të preparatit dhe metodës së aplikimit dhe karakteristikat e insekteve. Pastaj shumë me rëndësi është edhe përcaktimi i gjendjes reale i cili nënkupton identifikimin e insekteve që janë qëllim i eliminimit, përcaktimi i lokalitetit dhe vatrave, planifikimi i trajtimit, përcjellja e kushteve mikrometeorologjike, përzgjedhja e insekticidit, mënyra e trajtimit, monitorimi i zbatimit dhe përcaktimi i efikasitetit të veprimeve. Trajtimi kryesisht do të përqendrohet në eliminimin e mizave, mushkonjave dhe larvave të tyre andaj e shohim të nevojshme që të përmendim disa nga sëmundjet që përhapin këto dy grupe insektesh. Mizat janë vektor potencial për sëmundjet si: intoksikacionet alimentare, toxoinfeksionet alimentare, sallmonelozat, dizenteria, gastroenteritet, tyfoidet, kolera dhe tuberkulozi. Mushkonjat jetojnë prej 10 ditë deri 6 muaj, janë rreth 3.000 lloje, mund të transmetojnë sëmundje në njerëz dhe në kafshë si : malaria, filiriza, ethet e verdha, ethet dengue, ethet e Nilit Perëndimor, Chikungujën encefalitet si dhe shkaktojnë ndjenjë të pakëndshme dhe reaksione alergjike në rast të pickimi te njeriu.

#### QËLLIMI

Me këtë projekt synohet që të arrihen këto qëllime:

- Eliminimi ose sjellja në kufijtë të tolerancës epidemiologjike të insekteve fluturuese: mushkonjat dhe mizat
- Parandalimi dhe pengimi i përhapjes së sëmundjeve transitive që barten përmes insekteve që shërbejnë si vektorë.
- Eliminimi edhe i shumë shakatareve tjerë të dëmtimit të popullacionit bimor.
- Krijimi i kushteve për jetë më të qetë të qytetarëve.

## AKTIVITETET

**Dezinsektimi** hapësinor duhet te bëhet ne përputhje me legjislacionin në fuqi për shëndetin publik dhe ligjin për mbrojtjen e mjedisit. Duhet përdorur metodat më bashkëkohore me mjete të sofistikuar me aplikim nga toka. Gjithnjë duke u bazuar në rekomandimet e OBSH dhe CDC (Centre for Disease Control) (Qendra për kontrollin e Sëmundjeve) trajtimi duhet të fillojë në fund te muajit Maj, varësisht nga kushtet klimatike (atmosferike) dhe do të kryhet në **gjashtë faza\***.

\*(Vërejtje – Faza e gjashtë do të realizohet nëse ekspertët pranë QKMF-së, Menaxherët e Kontratës dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e konsiderojnë të nevojshme duke u bazuar në kushtet klimatike dhe popullacionin e insekteve gjatë periudhës kur kryhet ky proces)

Projekti është paraparë të kryhet në **gjashtë faza\*** me një interval kohor mes tyre prej 21 ditë, me qëllim që të zhduken edhe ato insekte që do të zhvillohen nga forma e tyre larvare në ndërkohë, që do të thotë se nëse merret parasysh edhe koha tjetër e nevojshme për përgatitje adekuate i tërë projekti do të zgjasë afër tre muaj, ne një vit.

**Do të trajtohet e tërë sipërfaqja e Komunës ( \_\_\_\_\_ ) me të gjitha lagjet, para-lagjet dhe zonat e Komunës si dhe fshatrat: ( \_\_\_\_\_ )**

**Sipërfaqja që do të trajtohet parashihet të jetë rreth ( \_\_\_\_\_ ) hektarë.** Kujdes i veçantë do ti kushtohet vendeve të përshtatshme për shumim, ushqim dhe pushim të insekteve e ato janë: sipërfaqet e gjelbërta, lumenjtë, përroskat, depot e mbeturinave dhe vendet me dendësi të madhe të popullatës. Do të synohet që insektet të goditen në fazën e tyre më aktive e që për mushkonja është fillimi i muzgut dhe orët e vona të mbrëmjes, kurse trajtimi për miza bëhet njëkohësisht gjatë trajtimit të mushkonjave. Qe të zvogëlohet popullata e mizave preferohet të trajtohen më shpesh kontejnerët e mbeturinave dhe deponitë e egra të mbeturinave. Komuna do te siguroj hartën e qytetit në të cilën janë të shënuara sipërfaqet e gjelbërta, përroskat, kolektorët e kanalizimit, deponitë e mbeturinave, tregjet me shumicë si dhe ndërtesat e larta. Komuna do te jete ne kontakt te vazhdueshëm me MMPH-Institutin hidrometeorologjik me qëllim të përcjelljes së kushteve mikrometeorologjike dhe drejtimin e fryrjes së erërave.

Do te përdoren Larvicidet dhe Insekticidet.

Larvicidet do të përdoren disa lloje të tyre varësisht nga vendi i aplikimit, koha, konfiguracioni i terrenit dhe në bazë të këtyre faktorëve do të përzgjidhet larvicidi më i përshtatshëm.

1. Bacillus Thuringiensis subspecies Israelensis 7000 (ITU/mg) dhe 400(ITU/mg) me efekt 14 ditorë.
2. Bacillus thuringiensis subspecies israelensis 7000 Aedes aegypti (AA) (ITU/mg) me efekt të zgjatur 30 ditorë ose ekuivalente
3. Larvicide me efekt rezidual – të zgjatur veprimi deri në 120 ditë i cili do të përdoret në lokacionet sensitive me materie aktive (S)-Methoprene. Si dhe preparate në bazë të vajit mineral (mineral oil) Poly dimethyl siloxane - Food grade white mineral oil ose ekuivalente.

Përzgjedhja e insekticidit është bërë bazuar në rekomandimet e OBSH-së për tretman me insekticid ekologjik i aprovuar nga EPA ose Organizatat tjera ndërkombëtare i cili tretet lehtë me ujë, është efikas me sasi të vogël të materies aktive, me shkallë të lartë të sigurisë për njerëz, kafshë dhe ambient, të jetë fotostabil, termostabil, pa fitotoksicitet, pa arome, pa ngjyrë, pa shije dhe me veti biodegradibile. Pastaj, faktor tjetër i cili përcakton llojin e insekticidit është edhe tretmani ULV me mjegullim të ftohtë dhe tretje me ujë i cili bëhet me insekticid që janë të përzier me komponente të posaqme që mundësojnë krijimin e aerosolit dhe mjegullës aktive. Preparati ne perberjen e tij duhet të ketë

substancë me veprim të zgjatur të veprimit. Ne preferojmë materie aktive **Permethrine 30%-Deltamethrin 30%** dhe **Bifenthrin 7.9%** ose ekuivalente. Doza e materies aktive duhet të jetë qartë e përcaktuar në specifikimet e produktit dhe në përputhje me rekomandimet nga OBSH-ja, EPA dhe organizatat tjera ndërkombëtare dhe legjislacioni i BE-së.

Aparatura e cila do të përdoret për këtë aktivitet duhet të jete e përshtatshme duke pasur parasysh ndjeshmërinë e aktiviteteve që ndermirën e që njëherit duhet ruajtur ekuilibrat biologjik-ekologjik si dhe mbrojtën e ambientit dhe shëndetit publik. Pajisjet duhet të kenë të specifikuar madhësinë e grimave të aerosolit të solucionit që shpërndahet në hapësirë, lartësinë e gjuajtjes grimcave të aerosolit të solucionit etj. Gjeneratorët ULV madhësia e mikrogrimcave që dalin nga ULV duhet të jetë jo më shumë se 20µ dhe lartësia e shtytjes se solucionit jo më pak se 15 metra. Gjithashtu për trajtimin e vendeve me dendësi të lartë bimësie ku nuk mund të depërtojnë gjeneratorët ULV me kamioneta do të përdoren pajisje adekuate për qasje në ato lokacione e të cilat janë specifikisht të destinuar për këto aktivitete, ato duhet të jenë të fuqishme dhe me presion të ulët veprimi me rezervuar të solucionit të përshtatshëm, gypa të gjatë deri në 100 metra me koka shtytëse të specifikuar për dezinfektim në menyre që të depërtohet sa më thellë në zonat e dendura me bimësi, parqe rekreative e të ngjashme. Me këtë metodë synohet të arrihet efikasitet edhe më i lartë i zvogëlimit të popullacionit të insekteve (mushkonjave, mizave).

Pompat motorikë ULV të krahut do të përdoren për dezinfektimin e hapësirave urbane ku makineritë e mëdha nuk mund të kenë qasje të hynë në ato zona për dezinfektimin e rrugicave, hapsirave urbane me bimë, kontejnerëve të mbeturinave dhe deponive të egra që gjinden në Komunën e \_\_\_\_\_, etj. Gjithashtu do të përdoren për hudhjen e solucionit larvicid si ai i lëngshëm i tretshëm po ashtu edhe i granular siç parashihet udhëzuesi i aplikimit të tyre.

Për të gjitha këto aktivitete personeli profesional i këtij shërbimi duhet të ketë të gjitha masat mbrojtëse sipas rregullave për përdorimin e insekticideve apo materieve tjera kimike, si dhe udhëheqësit e grupeve duhet të jenë të trajnuar për përdorimin e preparateve biocide dhe pajisjeve.

Në bazë të gjitha këtyre rekomandimeve dhe përparësive që u cekën më lartë, vijmë në përfundim se duhet të përdoren preparatet e testuar në aspektin toksikologjik dhe ekologjik, që gjenden në listën e preparateve të lejuara në listën e BE-së dhe të rekomanduara nga ana e OBSH-së . Përbërësit e këtyre substancave duhet të jenë me toksicitet sa më të ulët. Preparatet duhet të jenë të dedikuara për trajtim nga toka, zberthimi i substancës në raport me ujën të bëhet sipas udhëzimit të prodhuesit dhe sipas dozimit të përcaktuar dhe atëherë të përdoret përzjerja sipas sasisë të paraparë për sipërfaqe (1 hektar).

## **BASHKËPUNIMI**

Me qëllim të koordinimit të punëve rreth konkretizimit të projektit dhe duke pas parasysh se është veprim me efekt të përgjithshëm, ne do të bashkëpunojmë me Ministrinë e Shëndetësisë, IKSHP-në, MMPH, Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës me qëllim të sigurimit të informatave të nevojshme, me shoqatën e bletarëve, me mjete të informimit publik si dhe me qytetarë.

## **Raportimi**

Komuna në bashkëpunim me OE, nëpërmjet mjeteve të informimit shtyp, radio dhe TV, do të njoftoj popullatën për kohën e veprimeve dezinfektuese me qëllim të marrjes së masave mbrojtëse për njerëzit, kafshët, e sidomos për bletët. Gjatë këtyre informatave duhet të theksohet: hapësira dhe koha e paraparë për dezinfektim.

## 9.2 DERATIZIMI I GARAZHEVE /PODURIMEVE PUBLIKE DHE RRJETIT TË KANALIZIMIT

### a) Deratizimi i garazheve dhe podrumeve publike

Sipas Ligjit të aplikueshëm Nr. 02/L-109 e Nenit 20.I dhe Nenit 8 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e sëmundjeve ngjitëse duhet të bëhet Deratizimi i garazheve dhe podrumeve publike në qytet.

#### **Kriteret bazë të këtij aktiviteti duhet të jenë:**

- Për Deratizimin e garazheve dhe podrumeve publike duhet të përdoren: Preparatet deratizuese duhet të jenë antikuagulant të gjeneratës së dytë.
- Preparatet duhet të jenë në formë të blloqeve të parafinës e në vendet me lagështi duhet të vendosën blloqe rezistente në lagështi.
- Këto preparate duhet të vendosen në shtëpiza – stacione të mëdha dhe të vogla të cilat duhen të kenë shenjën e rrezikut (Helm –Posion) si dhe antidotin Vit. KI.
- Vendosja e preparati duhet të jetë në sasi prej **20gr.** Për 1 m<sup>2</sup>.

#### **Preparatet Deratizuese duhen të kenë:**

- Certifikatë të A-Testit,
- Afat të përdorimit,
- Deklaratë të prodhuesit dhe
- Certifikatë të cilësisë.

Me deratizim të garazheve dhe podrumeve publike do të përfshihet sipërfaqja prej (\_\_\_\_\_)m<sup>2</sup>.

Deratizimi i podrumeve dhe garazheve publike duhet të kryhet në dy faza :

- Faza pranverore (Mars – Qershor)
- Faza vjeshtore (Shtator – Dhjetor)

Ekipi ekzekutues për kryerjen e deratizimit të podrumeve dhe garazheve publike duhet të jetë i përberë nga: Një Epidemiolog dhe dy teknik sanitar të cilët duhet të kenë licencë pune .

### a) Deratizimi i rrjetit të kanalizimit ne Komunën e \_\_\_\_\_

#### **Kriteret bazë të këtij aktiviteti duhet të jenë:**

Për Deratizimin e rrjetit të kanalizimit duhet të përdoren

- Preparatet deratizuese antikuagulant të gjeneratës së dytë.
- Preparati duhet të jetë në formë të blloqeve të parafinës.
- Preparati duhet të vendoset në pusetë në sasi prej **300 gr.**
- Preparati duhet të jetë i lidhur me spagë dhe duhet të qëndroj mbi sipërfaqen e ujit 15cm-20cm.

#### **Preparatet Deratizuese duhen të kenë:**

- Certifikatë të A-Testit,
- Afat të përdorimit,
- Deklaratë të prodhuesit dhe
- Certifikatë të cilësisë.

Në rrjetin e kanalizimit në gjatësi prej (\_\_\_\_\_)km duhet të trajtohen (\_\_\_\_\_) **puseta** .

Deratizimi i rrjetit të kanalizimit duhet të kryhet në dy faza :

- Faza pranverore (Mars – Qershor) dhe
- Faza vjeshtore (Shtator – Dhjetor).

Për kryerjen e Deratizimit të rrjetit të kanalizimit ofertuesi duhet të ketë së paku (\_\_\_\_) personel ekzekutues një Epidemiolog të licencuar dhe dy teknik sanitar me licencë pune.

### **9.3 DEZINFEKTIMI, DEZINSEKTIMI DHE DERATIZIMI I INSTITUCIONEVE ARSIMORE**

#### **a) Deratizimi**

**Kriteret bazë të këtij aktiviteti duhet të jenë:**

Për Deratizimin e objekteve të institucioneve shkollore duhet të përdoren preparate Deratizues-rodenticid - antikuagulant të gjeneratës së dytë.

**Preparatet Deratizuese duhen të kenë:**

- Certifikatë të A-Testit,
- Afat të përdorimit,
- Lista teknike e sigurisë
- Lejen për importim dhe përdorim nga Ministria përkatëse.
- Preparati deratizues duhet të vendoset në shtëpiza (stacione)speciale me siguresa, në podrume, depo kthina ku fëmijët nuk kanë qasje si dhe në puseta të kanalizimeve brenda në objekt.
- Preparati duhet të vendoset në sasi prej 200gr. në 100m<sup>2</sup>
- Në vendet ku ka lagështi duhet të përdoret preparati me parafinë e që është rezistent ndaj lagështisë.
- Në vende të ndjeshme si kuzhina, depo ushqimi, vendet ku lëvizin fëmijët etj, duhet të përdoren pllaka ngjitëse për minj me aromë që nuk janë toksike për njerëzit.

#### **b) Dezinfektimi**

**Kriteret bazë të këtij aktiviteti janë:**

Për kryerjen e këtij aktiviteti duhet të përdoren preparatet dezinfektuese të spektrit të gjerë të veprimit si jo irrituese dhe jo koroduese, në bazë të H<sub>2</sub>O<sub>2</sub> (peroksidi i hidrogjenit).

### **Preparatet Dezinsektuese duhen të kenë:**

- Certifikatë të A-Testit,
- Afat të përdorimit,
- Lista teknike e sigurisë
- Lejen për importim dhe përdorim nga Ministria përkatëse.
  - Të jenë preparate që mund të përdoren në hapësira publike.
  - Preparatet duhet të jenë të aplikueshëm përmes aparaturës **ULV – elektrostatike** (shpërndarës i spërklave në formë uniforme).
  - Preparatet duhet të kenë veprim: baktericid, fungicid, virucid dhe kundër sporeve.
  - Preparatet dezinsektuese duhet të përdoren në bazë të udhëzuesit të produktit i cili caktohet nga prodhuesi.

### **c) Dezinsektimi**

#### **Kriteret bazë të këtij aktiviteti janë:**

Për kryerjen e këtij aktiviteti duhet të përdoren preparatet dezinsektuese si:

- Stacione të vogla me karem.
- Preparate në formë Gelli.
- Stacione me ngjitës, atraktant për insekte-furrtares dhe
- Preparate në formë të granulave.
- Substanca aktive e preparateve duhet të jetë në bazë të : Fipronil, Abamectin, Blouse, Imidacloprid.
- Preparate që treten me ujë e që materie aktive kanë perimetrin ose deltametrinë

### **Preparatet Dezinsektuese duhen të kenë:**

- Certifikatë të A-Testit,
- Afat të përdorimit,
- Lista teknike e sigurisë
- Leje për importim dhe përdorim nga Ministria përkatëse.
  - Preparatet e lëngshme aplikohen përmes aparaturave ULV elektrike dhe pompave spërkatëse me bateri që krijojnë presion mbi 2 bar, e që nuk krijojnë ndotje brenda hapësirave shkollore.
  - Preparatet përdoren sipas udhëzuesit të produktit i cili caktohet nga prodhuesi.

## 9.4 DERATIZIMI, DEZINFEKTIMI DHE DEZINSEKTIMI NË OBJEKTET SHËNDETËSORE

Sipas Ligjit të aplikueshëm Nr. 02/L-109 e Nenit 20.I dhe Nenit 8 të Ligjit për Parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse duhet të bëhet Deratizimi, Dezinfektimi dhe Dezinfektimi (DDD) i hapësirave të objekteve shëndetësore në \_\_\_\_\_.

### a) Deratizimi

- Për deratizimin e objekteve shëndetësore duhet të përdoren preparate deratizuese - rodenticid - antikuagulant të gjeneratës së dytë.
- Preparatet deratizuese duhet të jenë në formë blloku me parafinë të qëndrueshme ndaj lagështisë.
- Preparatet deratizuese duhet të kenë Certifikatë të analizës (Certifikatë të A – Testit), afat të përdorimit.
- Preparatet deratizuese si substancë aktive duhet të kenë: Brodifacoum 0.005% ose Bromadiolon 0.005%.
- Preparati deratizues duhet të vendoset në shtëpiza speciale me siguresa, qelës special në të cilat vendoset edhe mbishkrimi.
- Preparatet e vendosura në shtëpiza duhet të jenë në sasi prej 200gr. në 100m<sup>2</sup>
- Në vendet ku siguria duhet të jetë e lartë: njësitë pediatrike, njësitë e vaksinimit, njësitë e intervenimeve, kuzhina duhet të vendosen pllaka ngjitësi special.

### b) Dezinfektimi

Për kryerjen e këtij aktiviteti duhet të përdoren preparatet dezinfektuese të spektrit të gjërë të veprimit si jo irrituese dhe jo koroduese si në bazë të:

- H<sub>2</sub>O<sub>2</sub> (peroksidit të hidrogjenit),
- Komponentet aktive të amoniumit,
- Hipoklorit natriumi.
- Preparatet Dezinfektuese duhet të kenë Certifikatë të A-Testit, afat të përdorimit.
- Të jenë preparate që mund të përdoren në hapësira publike dhe objekte shëndetësore.
- Preparatet duhet të jenë të aplikueshëm përmes aparaturës **ULV – ELEKTROSTATIKE** (shpërndarës i spërklave në formë uniforme).
- Preparatet duhet të kenë veprim: baktericid, fungicid, virucid dhe kundër sporeve.
- Preparatet dezinfektuese duhet të përdoren në bazë të udhëzuesit të produktit i cili caktohet nga prodhuesi.

### c) Dezinfektimi

Për kryerjen e këtij aktiviteti duhet të përdoren preparatet dezinfektuese si:

- Preparatet në formë Gelli.



- Stacione me ngjitës, atraktant për insekte - furtare dhe
- Preparate në formë të granulave apo solucione.
- Preparatet dezinfektuese në përbërjen e tyre duhet të kenë njërin nga substancat aktive si:
  - Fipronil në formë gjeli 0.01%
  - Fipronil solucion 9.1%
  - Imidacloprid 10%
  - Z-9-Tricosene 0.1%
  - Lambda-cyhalothrin 9.7% ose Binfenthrin 7.9%
- Preparatet Dezinfektuese duhen të kenë:
  - Certifikatë të A-Testit,
  - Afat të përdorimit,
  - Deklaratë të prodhuesit.

## **10 . LARJA E JASHTME DHE PASTRIMI I BRENDSHËM I AUTOMJETEVE ZYRTARE**

### **Specifikimi teknik/TeR**

Ofruesi i Shërbimeve duhet të ketë kapacitetin për të ofruar shërbime të autolarjes të automjeteve të specifikuar.

Ofruesi i Shërbimeve duhet të ketë hapësirë të mjaftueshme dhe mekanizim adekuat me qëllim të larjes së jashtme dhe të brendshme të automjeteve.

Ofruesi i Shërbimeve duhet ti japë përparësi larjes së automjeteve në raport me automjetet në pronësi të personave të tjerë fizik. Shërbimi të kryhet max. brenda 1 ore.

Ofruesi i Shërbimeve do të emërojë një përfaqësues, i cili do të veprojë si pikë kontaktuese e ofruesit të shërbimeve për të gjitha çështjet që lidhen me kontratën. Ky përfaqësues do të ketë autoritetin e duhur për të marrë vendime të shpejta dhe të zgjidhë çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës.

Autoriteti Kontraktues do të emërojë një Menaxher të Kontratës si pikë fokale ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe OE i cili do të ketë autoritetin për të marrë vendime të shpejta dhe të zgjidhë çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës.

### **Specifikat:**

- Larja e jashtme të bëhet me shampon adekuat për automjete
- Të bëhet tharja( terja) e automjetit;
- Pastrimi i brendshëm përfshinë: Thithjen e pluhurit me thithëse elektrike nga tepihët dhe ulëset e automjeteve. Pastrimi i interiorit të brendshëm të dyerve, kokpitit dhe pjesëve tjera, pastrimi i pjesëve plastike të brendshme duke përdorur sprej mbrojtës. Pastrimi i sipërfaqeve të bagazhit të automjetit.

## Llojet dhe sasia e automjeteve:

### Lista e veturave për pastrim (larje)

| Nr. | Lloji i Automjetit   | Nr. Targave | Viti i Prodhimit | Kapaciteti (në cm 3) |
|-----|----------------------|-------------|------------------|----------------------|
| 1   | A6 3.0 TDI AUDI      | 3Z-001-12   | 2012             | 2967                 |
| 2   | Peugeot              | 3Z-222-12   | 2018             | 1998                 |
| 3   | Peugeot              | 3Z-223-12   | 2018             | 1998                 |
| 4   | Peugeot              | 01-949-SH   | 2018             | 1998                 |
| 5   | Renault              | 3Z-209-12   | 2017             | 1586                 |
| 6   | Renault              | 3Z-210-12   | 2017             | 1586                 |
| 7   | Renault              | 3Z-211-12   | 2017             | 1586                 |
| 8   | C 180 SEDAN MERCEDES | 3Z-002-12   | 2002             | 1998                 |
| 9   | POLO 1.9 SDI VW      | 3Z-115-12   | 2004             | 1896                 |

## **Shembull i një liste e kërkesave të veçanta për LARJE DHE PASTRIM TE VETURAVE**

### Kërkesat e kualifikimit

#### **Aftësitë teknike dhe profesionale:**

Operatori Ekonomik duhet që të ketë Objektin – Punëtorinë për larjen e veturave jo më larg se xx (te përcaktohen km) nga Ndërtesa e AK, bazuar në rrugën me të afërt tokësore të asfaltuar.

Shënim: Te drejte ofertimi kanë të gjithë Operatorët Ekonomik, pa marrë parasysh se në cilin vend apo lokalitet kanë selinë e regjistrimit të kompanisë por bazuar në parimin e efikasitetit dhe ekonomikitetit, Operatorët Ekonomik që ofertojnë duhet që Objektin – Punëtorinë për larjen e veturave ta kanë në pronësi apo ta marrur me qira, ta kenë jo më larg se xx (te përcaktohen km) nga Ndërtesa e AK, bazuar në rrugën me të afërt tokësore të asfaltuar.

#### *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

Nëse Objekti - punëtoria është në pronësi si dëshmi kërkohen kopjet e dokumentacionit të pronësisë.

Nëse objekti - punëtoria është marrë me qira si dëshmi kërkohet kopja e kontratës së qirasë. Ndërsa vendet për larje të dëshmohen me fotografi ose dokumentacion tjetër dëshmues.

## Lista e Cmimeve

| LISTA E CMIMEVE          |   |                           |                         |      |                         |                     |
|--------------------------|---|---------------------------|-------------------------|------|-------------------------|---------------------|
| Ministria e Shëndetësisë |   |                           |                         |      |                         |                     |
| Nr.                      | Shërbimet e pastrimit                           | Njesia Numri i pastrimeve | Çmimi për njësi pa TVSH | TVSH | Çmimi për njësi me TVSH | Çmimi total me TVSH |
| 1                        | Pastimi brenda dhe jashtë i veturave (limuzina) | 1056                      |                         |      |                         |                     |
| 2                        | Pastrimi brenda dhe jashtë i veturave (Xhipa)   | 192                       |                         |      |                         |                     |
| GRAND TOTAL              |   |                           |                         |      |                         |                     |

## I I. SIGURIMI DHE KONTROLLIMI TEKNIK I AUTOMJETEVE ZYRTARE

### Specifikimi teknik

Ofruesi i Shërbimeve duhet të ketë kapacitetin për të ofruar shërbime të Sigurimit të automjeteve të specifikuar dhe Kontrollimit teknik.

Ofruesi i Shërbimeve do të emërojë një përfaqësues, i cili do të veprojë si pikë kontaktuese e ofruesit të shërbimeve për të gjitha çështjet që lidhen me kontratën. Ky përfaqësues do të ketë autoritetin e duhur për të marrë vendime të shpejta dhe të zgjidhë çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës.

Autoriteti Kontraktues do të emërojë një Menaxher të Kontratës si pikë fokale ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe OE i cili do të ketë autoritetin për të marrë vendime të shpejta dhe të zgjidhë çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës.

Kompania e sigurimeve duhet t'i plotësojë të gjitha kriteret e sigurimeve në bazë të rregullores mbi sigurimin e automjeteve.

Kompania e sigurimeve duhet të ketë një marrëveshje bashkëpunimi me një Kompani e cila është e licencuar për kontrollim teknik.

Kompania e sigurimeve merre përgjegjësinë e plotë që brenda afatit kohor prej 15 ditëve të bëjë, riparimin-montimin dhe rregullimin e plotë (në gjendjen e me hershme) të automjeteve.

Kompania e sigurimeve duhet t'i ketë, serviset për riparimet e tërësishme të aksidenteve (dëmeve).

### Referencat për Sigurim dhe kontrollim teknik të automjeteve.

- 1 Sigurimi, TPL-Auto përgjegjësisë**
- 2 Sigurimi, TPL-PLUS Sigurimi kufitar**
- 3 Sigurimi, KASKO i plotë 100%, pa asnjë lloje participimi nga AK, pa zbritje të detyrueshme në (franshizë). Kasko duhet të mbuloi territorin e Republikës së Kosovës dhe për vendet e rajonit (Shqipëri, Mali i Zi dhe Maqedoni). Deklaratë me shkrim.**
- 4 Kontrollimi teknik.**

## Llojet dhe sasia e automjeteve:

| Nr. | Lloji i Automjetit   | Nr. Targave | Viti i Prodh. | Kapaciteti (në cm <sup>3</sup> ) | Vlerat e automjeteve ne vitin 2023 | TPL | TPL+ | KASKO | Kontrollimi Teknik |
|-----|----------------------|-------------|---------------|----------------------------------|------------------------------------|-----|------|-------|--------------------|
| 1   | A6 3.0 TDI AUDI      | 3Z-001-12   | 2012          | 2967                             | 13,000.00                          | Po  | Po   | Po    | Po                 |
| 2   | C 180 SEDAN MERCEDES | 3Z-002-12   | 2002          | 1998                             |                                    | Po  |      |       | Po                 |
| 3   | POLO 1.9 SDI VW      | 3Z-115-12   | 2004          | 1896                             |                                    | Po  |      |       | Po                 |
| 4   | POLO 1.9 SDI VW      | 3Z-166-12   | 2004          | 1896                             |                                    | Po  |      |       | Po                 |
| 5   | FABIA 1.9 SDI SHKODA | 3Z-151-12   | 2004          | 1896                             |                                    | Po  |      |       | Po                 |
| 6   | NH (RAPID) SKODA     | 3Z-201-12   | 2016          | 1596                             | 7,000.00                           | Po  |      | Po    | Po                 |
| 7   | NH (RAPID) SKODA     | 3Z-202-12   | 2016          | 1596                             | 7,000.00                           | Po  |      | Po    | Po                 |
| 8   | NH (RAPID) SKODA     | 3Z-203-12   | 2016          | 1596                             | 7,000.00                           | Po  | Po   | Po    | Po                 |
| 9   | NH (RAPID) SKODA     | 3Z-020-12   | 2013          | 1596                             | 5,500.00                           | Po  |      | Po    | Po                 |

## Shembull i një liste e kërkesave të veçanta për sigurim te automjeteve

### Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale:

- Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se sigurimi do të jete KASKO i plotë 100%, pa asnjë lloje participimi nga AK, pa zbritje të detyrueshme në (franshizë). KASKO duhet të mbuloi territorin e Republikës së Kosovës dhe për vendet e rajonit (Shqipëri, Mali i Zi dhe Maqedoni).
- Operatori ekonomik pjesëmarrës duket të dorëzoj marrëveshjen e bashkëpunimit me Kompaninë qe do të beje kontrollimin teknik si dhe duhet të bashkëngjis Licencën e Kompanisë për kontrollim teknik te Automjeteve.

### Dëshmia

- Deklaratë me shkrim të nënshkruar dhe vulosur nga OE që dëshmon se sigurimi KASKO i plote 100%, do të jetë i plotë, pa asnjë lloje participimi nga AK dhe pa zbritje të detyrueshme në franshizë si dhe deklarate se KASKO mbulon territorin e Republikës së Kosovës dhe vendet e rajonit (Shqipëri, Mali i Zi dhe Maqedoni).
- Kopje e marrëveshjes se bashkëpunimit dhe kopja e licencës e lëshuar nga Institucioni përkatës për ofrimin e shërbimeve te kontrollimit teknik te automjeteve

## Lista e Çmimeve

| LISTA e ÇMIMEVE   |                      |             |               |                                  |                                    |     |      |       |                       |                        |                         |                                    |                     |
|---|----------------------|-------------|---------------|----------------------------------|------------------------------------|-----|------|-------|-----------------------|------------------------|-------------------------|------------------------------------|---------------------|
| Regjistri i automjeteve të MSH-së për sigurim dhe kontrollim teknik |                      |             |               |                                  |                                    |     |      |       |                       |                        |                         |                                    |                     |
| Nr.   | Lloji i Automjetit   | Nr. Targave | Viti i Prodh. | Kapaciteti (në cm <sup>3</sup> ) | Vlerat e automjeteve ne vitin 2019 | TPL | TPL+ | KASKO | Çmimi per TPL me TVSH | Çmimi per TPL+ me TVSH | Çmimi per KASKO me TVSH | Çmimi per kontroll teknike me TVSH | CMIMI TOTAL me TVSH |
| 1   | A6 3.0 TDI AUDI      | 3Z-001-12   | 2012          | 2967                             | 13,000.00                          | Po  | Po   | Po    |                       |                        |                         |                                    |                     |
| 2   | C 180 SEDAN MERCEDES | 3Z-002-12   | 2002          | 1998                             |                                    | Po  |      |       | n/a                   | n/a                    |                         |                                    |                     |
| 3   | POLO 1.9 SDI VW      | 3Z-115-12   | 2004          | 1896                             |                                    | Po  |      |       | n/a                   | n/a                    |                         |                                    |                     |
| 4   | POLO 1.9 SDI VW      | 3Z-166-12   | 2004          | 1896                             |                                    | Po  |      |       | n/a                   | n/a                    |                         |                                    |                     |
| 5   | FABIA 1.9 SDI SHKODA | 3Z-151-12   | 2004          | 1896                             |                                    | Po  |      |       | n/a                   | n/a                    |                         |                                    |                     |
| 6   | NH (RAPID) SKODA     | 3Z-201-12   | 2016          | 1596                             | 7,000.00                           | Po  |      | Po    | n/a                   |                        |                         |                                    |                     |
| 7   | NH (RAPID) SKODA     | 3Z-202-12   | 2016          | 1596                             | 7,000.00                           | Po  |      | Po    | n/a                   |                        |                         |                                    |                     |
| 8   | NH (RAPID) SKODA     | 3Z-203-12   | 2016          | 1596                             | 7,000.00                           | Po  | Po   | Po    |                       |                        |                         |                                    |                     |
| 9   | NH (RAPID) SKODA     | 3Z-020-12   | 2013          | 1596                             | 5,500.00                           | Po  |      | Po    | n/a                   |                        |                         |                                    |                     |

